



Komuna:
Fushë-Kosovë
2012/2017

...për qytetin tim!

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis



Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

2012/2017



Komuna: Fushë-Kosovë

Projekti është financuar nga:



Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Zbatimi i projektit është mbështetur edhe nga:



MMPH dhe MAPL.

Ky projekt është zbatuar nga:



REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë.

Botim i Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë.
<http://kosovo.rec.org/>; <http://www.rec.org/>

PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2012/2017

Copyright © 2012 REC

Të drejtat e botimit të këtij publikimi i mban:

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë

Design & Layout: Arben Grajqevci (Rrjeti)

Shtypi: RRJETI, Prishtinë

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Ç'është REC? | 7 |
| Fjala e Kryetarit të Komunës..... | 9 |
| Fjalorthi i shkurtesave..... | 10 |
| Akterët dhe përgjegjësitë e PLVM-së..... | 11 |

Pjesa 1

| | |
|---|----|
| I. HYRJE | 15 |
| Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së | 15 |
| Plani lokal për Veprim në Mjedis ka për qellim të: | 15 |
| Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së | 16 |
| Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:..... | 17 |
| Përmbledhje ekzekutive e gjendjes ne mjedis | 19 |
| Zhvillimi urban, shfrytëzimi i tokës/ave dhe karakteristikat e dheut..... | 20 |

Pjesa 2

| | |
|---|----|
| Të dhënat e përgjithshme për Komunën e Fushë-Kosovës | 21 |
| 2.1. Historiku..... | 21 |
| 2.2. Pozita gjeografike | 22 |
| 2.3. Ndarja administrative e territorit të Komunës së Fushë-Kosovës | 23 |
| 2.4. Karakteristikat gjeologjike | 23 |
| 2.5. KLIMA..... | 24 |
| 2.5.1. Temperatura e ajrit | 24 |
| 2.5.2. Era | 24 |
| 2.5.3. Lagështia relative e ajrit..... | 24 |
| 2.5.4. Të reshurat | 24 |
| 2.6. Karakteristikat hidrologjike-lumenjtë | 25 |
| 2.7. BURIMET E UJIT | 26 |
| 2.7.1. Gjendja fizikio-kimike e ujërave | 27 |
| 2.7.2. Gjendja bakteriologjike | 27 |
| 2.8. Karakteristikat pedologjike..... | 27 |
| 2.8.1. Tokat aluviale (fluvisol) | 27 |
| 2.8.3. Klasa e tokës | 27 |
| 2.9. POPULLSIA | 28 |
| 2.9.1. Struktura e popullsisë | 28 |
| 2.9.2. Struktura gjinore..... | 29 |

| | | |
|---------|---|----|
| 2.9.3. | Struktura etnike | 29 |
| 2.10. | EKONOMIA | 30 |
| 2.10.1. | Numri dhe Struktura e Bizneseve | 30 |
| 2.11. | Bujqësia dhe Blegtoria | 31 |
| 2.12. | Turizmi dhe Hoteleria | 31 |
| 2.12. | Komuniteti i Biznesit | 32 |
| 2.13. | NFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE..... | 32 |
| 2.13.1. | Ujësjellësi..... | 32 |
| 2.13.2. | Kanalizimi dhe ujërat e zeza..... | 32 |
| 2.13.3. | Rrjeti i kanalizimit i ujërave të bardha..... | 33 |
| 2.13.4. | Infrastruktura rrugore në rajonin e Fushë-Kosovës | 33 |
| 2.13.5. | Transporti publik | 33 |
| 2.13.6. | Komunikacioni hekurudhor | 33 |
| 2.13.7. | Furnizimi me energji elektrike | 34 |
| 2.13.8. | Sistemi i Telekomunikimit | 34 |
| 2.14. | Shërbimet sociale | 34 |
| 2.14.1. | Shëndetësia..... | 35 |
| 2.15. | ARSIMI | 37 |
| 2.16. | TRASHËGIMIA KULTURORE..... | 38 |
| 2.16.1. | Kultura, sporti dhe rekreacioni | 39 |
| 2.16.2. | Qendra Rinore – Fushë-Kosovë..... | 40 |
| 2.16.3. | Sportet amatore..... | 40 |
| 2.17. | RESURSET NATYRORE..... | 41 |
| 2.17.1. | Resurset minerale | 41 |
| 2.17.2. | Toka bujqësore | 41 |

Pjesa 3

| | | |
|-------------------------|--|----|
| GJENDJA E MJEDISIT..... | 43 | |
| 3.1. | Menaxhimi i ajrit | 44 |
| 3.2. | Menaxhimi i ujit..... | 45 |
| 3.2.1. | Resurset ujore | 45 |
| 3.2.2. | Ndotja e resurseve ujore | 46 |
| 3.2.3. | Monitorimi i cilësisë dhe sasisë së ujërave..... | 47 |
| 3.2.4. | Menaxhimi urban i kanalizimit..... | 48 |
| 3.3. | Menaxhimi i mbeturinave | 48 |
| 3.3.1 | Mbeturina të tjera..... | 49 |
| 3.4. | ZHVILLIMI URBAN DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS..... | 49 |
| 3.4.1. | Zhvillimi Urban..... | 49 |
| 3.4.2. | Vendbanimet joformale | 50 |
| 3.4.3. | Ndriçimi publik në Komunë | 50 |
| 3.4.4. | Industria..... | 50 |
| 3.5. | Bujqësia..... | 51 |
| 3.5.1. | Lavërtaria..... | 51 |

| | | |
|--------|---|----|
| 3.5.2. | Perimtaria | 51 |
| 3.5.3. | Blegtoria..... | 52 |
| 3.5.4. | Bletaria | 52 |
| 3.6. | Veterinaria | 53 |
| 3.7. | Biodiversiteti dhe trashëgimia natyrore | 53 |
| 3.8. | Pylltaria | 54 |
| 3.8.1. | Sipërfaqja e tokave pyjore | 55 |
| 3.8.2. | Gjendja e pyjeve | 55 |
| 3.8.3. | Degradimi i pyjeve | 55 |
| 3.8.4. | Pyllëzimi i pyjeve | 55 |
| 3.9. | Dukuritë natyrore dhe të shkaktuara | 56 |
| 3.9.1. | Zjarret | 56 |
| 3.9.2. | Eksplodimet..... | 56 |
| 3.9.3. | Aksidentet në komunikacion..... | 56 |
| 3.9.4. | Aksidentet nga mbeturinat e luftës | 56 |
| 3.9.5. | Tërmetet | 57 |

Pjesa 4

| | | |
|------|--|----|
| | REZULTATET E ANKETËS DHE PRIORITETET | 59 |
| 4.1. | Hulumtimi i opinionit publik në Komunën e Fushë-Kosovës për gjendjen mjedisore dhe problemet mjedisore me prioritet..... | 59 |
| 4.2. | Metodologjia | 59 |
| 4.3. | Rezultatet e anketës..... | 59 |

Pjesa 5

| | | |
|--|------------------------------------|----|
| | Analiza e problemit mjedisor | 63 |
|--|------------------------------------|----|

Pjesa 6

| | | |
|--|-----------------------------|-----|
| | PLANI I VEPRIMIT | 67 |
| | Literatura/Referencat | 101 |



Ç'është REC?

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) është organizatë ndërkombëtare neutrale, joavokuese dhe jofitimprurëse, e cila mbështet zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL). Kjo qendër e përmbush misionin duke promovuar bashkëpunim ndërmjet Organizatave Jo Qeveritare (OJQ), qeverive, bizneseve si dhe personave tjerë kyç mjedisor si dhe duke përkrahur këmbimin e lirë të informatave dhe pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen për mjedis. REC është themeluar në vitin 1990 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Komisioni Evropian dhe Hungaria.

Aktualisht, REC bazohet ligjërisht në Kartën e vet, nënshkruar nga qeveritë e 29 vendeve dhe Komisioni Evropian dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë e Hungarisë. Zyra qendrore e REC-ut është në Szentendre, Hungari si dhe zyrat fushore dhe zyrat e shteteve në 17 vendet përfituese.



Fjala e Kryetarit të Komunës

Të nderuar qytetarë të Fushë-Kosovës, unë si Kryetar i Komunës së Fushë-Kosovës, kam nderin dhe kënaqësinë që t'ju informoj me procesin e Hartimit të Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM).

Për realizimin e suksesshëm të këtij projekti është formuar Trupi Koordinues prej (shtatë) 7 anëtarësh, në nivel komunal, pjesë e të cilit isha edhe unë. Po ashtu, është formuar edhe Grupi Punues prej (njëzet anëtarësh) 20 për Hartimin e PLVM-së, me përfaqësues komunalë dhe me shumicë dërmuese të njohësve (profesionistë dhe specialistë) të fushave të ndryshme (Mbrotjtje të mjedisit, urbanizmit, shëndetësisë, gjelbërimit, arsimit, komunikacionit, bujqësisë, ekonomisë, integritime evropiane, barazi gjinore), si dhe nga Organizatat Joqeveritare (OJQ) dhe nga kompanitë publike. Pjesë e këtij grupi ishte edhe Koordinatorja e Qendrës Rajonale për Mjedis (Regjional Environmental Center-REC) për Fushë-Kosovë.

Gjatë hartimit të këtij plani janë marrë edhe opinionet dhe kontributet e qytetarëve të Komunës tonë. Gjatë viteve të fundit, qyteti i Fushë-Kosovës u përball me probleme të ndryshme si: ardhjen e popullsisë nga viset e Kosovës Lindore, ashtu edhe nga viset tjera anembanë Kosovës, rritjen e kërkesave për investime në infrastrukturë, rritjen e bizneseve dhe vështirësitë e tjera ekonomike për të përballuar kërkesat e kohës për investime publike. Të gjitha këto u shoqëruan me shqetësime mjedisore të cilat iu shtuan edhe ato të trashëguara para luftës. Përballë këtyre problemeve, Komuna u dëmtua në mënyra të ndryshme.

Megjithatë, angazhimi i palodhshëm komunal dhe qytetarë u ndihmua në tejkalimin e problemeve. Qyteti i Fushë-Kosovës, me fshatra, është i kompletuar me sistem të kanalizimit, falë investimeve nga donatorët dhe nga Komuna e Fushë-Kosovës. Vazhdon projekti për eliminim të depove të egra, të krijuara në vitet e fundit dhe për menaxhim më të mirë të mbeturinave kemi vendosur krijimin e një sistemi të mirëfilltë për mbledhje dhe depozim të mbeturinave (Furnizim me kontejnerë në të gjitha lokalitetet banuese).

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është një dokument pune, i cili pritet të shërbejë si hap i parë i thithjes së investimeve për përmirësimin e mjedisit në Fushë-Kosovë, për vitet e ardhshme.

Qyteti dhe Komuna e Fushë-Kosovës është në rrugë drejtë suksesit dhe ne dëshirojmë që edhe ju të jeni pjesë e kësaj rruge. Shpresoj që ky dokument të jetë i dobishëm për ju dhe jeni gjithmonë të mirëpritur të punojmë së bashku për të ardhmen tonë.

Në përmbyllje të kësaj dua të falënderoj REC-un dhe Sida-an, për ndihmën dhe trajnimet e ofruara të zyrtarëve tanë në përpilim të këtij dokumenti.

Sinqerisht:
 z. Burim Berisha
 Kryetar i Komunës së Fushë-Kosovës

Fjalorthi i shkurtesave

| | |
|-------------|---|
| KK | - Kuvendi Komunal |
| KEK | - Korporata Elektro-Energjetike e Kosovës |
| AKMM | - Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit |
| APK | - Agjencioni Pyjor i Kosovës |
| ASK | - Agjencioni i Statistikave të Kosovës |
| BE | - Bashkimi Evropian |
| IKSHPK | - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës |
| ISHP | - Instituti i Shëndetit Publik |
| MAPL | - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| MMPH | - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| MShP | - Ministria e Shërbimeve Publike |
| OBSH | - Organizata Botërore e Shëndetësisë |
| OJQ | - Organizata Joqeveritare |
| PKVM | - Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis |
| PLVM | - Plani Lokal i Veprimit në Mjedis |
| PM10, PM2.5 | - Grimcat e suspenduara në ajër |
| PZHK | - Plani Zhvillimor Komunal |
| PZHU | - Plani Zhvillimor Urban |
| VNM | - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis |
| VSM | - Vlerësimi Strategjik Mjedisor |
| QKMF | - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare |
| REC | - Qendra Rajonale e Mjedisit |
| Sida | - Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtarë |

Akterët dhe përgjegjësitë e PLVM-së

Ky Projekt është implementuar nga:

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC (Regional Environmental Center) - Zyra në Kosovë.

Koordinatorë e REC për PLVM:

Shqipe Morina

Komuna e Fushë-Kosovës

Koordinator i Komunës për PLVM:

Adnan Bullatovci

Anëtarët e Trupit Koordinues:

1. Burim Berisha - Kryetar i Komunës
2. Abdulla Prebreza - Drejtor për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
3. Ramadan Jashanica - Drejtor për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim
4. Maliq Berisha - Drejtor për Shërbime Publike
5. Mehmet Gërguri - Drejtor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
6. Adnan Bullatovci - Zyrtar i Lartë për Mbrojtje të Mjedisit - Koordinator
7. Millanka Bojkoviç - Zyrtare për Financa

Personat dhe grupet e ndryshme që janë përfshirë në hartimin e PLVM-së për Komunën e Fushë-Kosovës janë:

1. Mehmet Gërguri - Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
2. Nuriye Avdiu - Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Adnan Bullatovci - Zyrtar i Lartë për Mbrojtje të Mjedisit
4. Antigona Sahiti - Shefe e Zyrës për Planifikim Urban
5. Fatime Ismajli - Zyrtare për Planifikim Urban
6. Lindita Dervisholli - Koordinatorë e Zyrës për Barazi Gjinore
7. Hasan Gjyrevci - Zyrtar Ligjor
8. Blerim Berisha - Inspektor Sanitar
9. Hysen Sllamniku - Koordinator i Zyrës për Çështje Sociale
10. Ejup Qyqalla - Shef i Shërbimeve Publike
11. Bardhyl Koiçiçi - Shef për Buxhet
12. Ilmije Zymberi - Shefe për Arsim
13. Ferdane Asllani - Përfaqësuese për Komunitetet: Rom, Ashkalinj dhe Egjiptian
14. Nuriye Fazliu - Zyrtare për Integritim Evropian
15. Rexhep Gojnovci - Përfaqësues nga OJQ “Akti”
16. Hajrije Berisha - Përfaqësuese nga OJQ “Amici De Bambini”
17. Bekim Rexha - Zyrtar
18. Veselin Petroviç - Përfaqësues nga Komuniteti Serb
19. Naim Tmava - Përfaqësues nga Kompania “Pastrimi”
20. Ali Topalli - Zëdhënës i Komunës

Anëtarët e tjerë ndihmës:

1. Gëzim Shabani - Zyrtar për Ujësjetje dhe Kanalizim - DSHPE
2. Shpresa Qerimi - Zyrtare për Pronë
3. Isuf Maxhera - Agronom
4. Nazmi Rama - Policia e Kosovës

Baza ligjore për hartimin e PLVM-së



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 26.09.2011

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 20.09.2011, pas shqyrtimit të Propozimit, Nr. 333, të datës 14.09.2011, paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 17, shkronja (e), 40.2 shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, nenin 6 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 03/L-025 dhe nenin 12.1 shkronja (d), 27 shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 56, i datës 29.04.2010, mori:


V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 20,000.00€ për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
- II. Projekti për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis, për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës është përkrahur me mjete financiare, në shumë prej 40,000.00€, nga Qendra Rajonale për Mjedis për Evropën Qendrore dhe Lindore.
- III. Sigurimi i mjeteve financiare nga pika një (1) e vendimit për realizimin e projektit për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis, bëhet nga buxheti i Komunës.
- IV. Kryerja e procedurave tjera është në kompetencë të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- V. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për FEZH, Drejtorisë për PUKMM, Drejtorisë për BZHR dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Jakup Tërnavë



Legjislacioni i Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes te mjedisit harmonizuar me standardet evropiane që është përdorur si referencë për përgatitjen e PLVM-së.

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (2009/03-L-025)
- Ligji për Mbeturinat (2005/02-L30)
- Ligji për Mbrojtjen e ajrit (2004/30)
- Ligji për Mbrojtjen e bimëve (2006/02-L95)
- Ligji për Mbrojtjen e natyrës (2005/02-L18)
- Ligji për Mbrojtjen e varieteteve të bimëve (2007/02-L98)
- Ligji për Mbrojtjen nga zhurma (2007/02-L102)
- Ligji për Mbrojtjen nga zjarri (2006/02-L41)
- Ligji për Bujqësi dhe zhvillim rural (2009/03-L-98)
- Ligji për Bujqësi organike (2007/02-L122)
- Ligji për Gjuetinë (2005/02-L53)
- Ligji për Plehrat Artificiale (2003/10)
- Ligji për Planifikim Hapësinorë (2003/14)
- Ligji për Pyjet ndryshim (2004/29)
- Ligji për Ujërat (2004/24)
- Ligji për Ujitjen e tokave bujqësore (2005/02-L9)
- Ligji për Vlerësimin e ndikimit në mjedis (2009/03-L-024)
- Ligji për Vetëqeverisje Lokale (2008/03-L040)
- Ligji për Zonat e veçanta të mbrojtura (2008/03-L039)
- Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (2009/03-L-015)
- Udhëzimi administrativ Nr 02/07 për mbeturina nga Bateritë dhe Akumulatorët
- Udhëzimi administrativ Nr 03/07 për administrimin e vajrave të përdorura mbeturinë
- Udhëzimi administrativ për automjete e hedhura dhe mbeturinat e tyre, 20.12. 2006
- Udhëzimi administrativ Nr. 12/2008 për asgjësimin e mbeturinave medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2008 për administrimin me mbeturinat medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2009 për administrimin e mbeturinave publike
- Udhëzimi administrativ Nr. 04/2009 për ndëshkime dhe gjoba mandatore
- Planin Kombëtarë për Veprim në Mjedis i Kosovës, 2006-2010

Pjesa 1

I. HYRJE

Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM) janë dokumente të politikës mjedisore vendore, të cilat paraqesin prioritete mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Përgatitja e këtyre planeve zhvillon më tej aftësitë e pushtetit vendor dhe subjekteve të tjera të interesuara për mjedisin dhe komunitetin.

Gjithashtu, PLVM nxit bashkëpunimin midis shoqërisë civile, publikut, pushtetit vendor dhe atij qendror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së

Përgatitja e PLVM-së është e detyrueshme për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që kanë filluar procesin e asocim-stabilizimit dhe që synojnë të integrohen në BE. Për vendin tonë, hartimi i këtyre planeve nga qeverisjet vendore është detyrë ligjore, e përcaktuar në Nenin 24 të **Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr.03/L-25**

Plani lokal për Veprim në Mjedis ka për qëllim të:

- Zgjidh problemet mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Zhvillojnë shoqërinë civile nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm në komunitet, duke sjellë së bashku përfaqësues të komuniteteve të ndryshme që përfaqësojnë interesa të ndryshme në këto komunitete, përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të OJQ-ve, biznesin, shkencëtarë, duke shpjeguar teknikat specifike që organizatorët lokalë mund të përdorin për të përcaktuar aktorët kryesorë të procesit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut në proces, për rekrutimin dhe punën me vullnetarët dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesuara dhe organizatave.

- Rrisin aftësitë e qeverisjes vendore dhe komunitetit për paraqitjen e elementëve thelbësore të planit të veprimit të komunitetit, duke vlerësuar problemet dhe mundësitë komunitare, duke organizuar komitete qytetare, duke përfshirë publikun, përcaktimin e prioriteteve, hartimin e strategjive dhe zhvillimin e një Plan Veprimi.
- Rrisin shkëmbimin e informacionit në nivel lokal nëpërmjet sjelljes së shembujve dhe modeleve nga plane të mëparshëm të komuniteteve nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informacion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.
- Japin zgjidhje konkrete për problemet e komunitetit me anë të shkëmbimit të përvojave lidhur me përdorimin e aftësive në analiza, planifikime, debate dhe vlerësime që janë thelbësore për një veprim të komunitetit efektiv. Duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për të vënë në praktikë punën në grupe, duke u marrë me zgjidhjen e problemeve praktike nëpërmjet ndërveprimit të grupeve të vogla të punës.

Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Fushë-Kosovës u hartua përgjatë një periudhe njëvjeçare dhe në hartimin e tij janë përfshirë akterët të pushtetit vendor dhe komuniteti i gjerë. Për këtë u ngrit një grup pune me specialistë të fushave të ndryshme (ambientalizëm, arkitekturë, turizëm, shëndetësi, arsim, sport, trashëgimi kulturore, etj.), të cilët punuan në bashkëpunim me ekspertë tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë për hartimin e PLVM-së.

Së pari, është bërë trajnimi i përfaqësuesve të komunave të cilët janë të futur në projekt në aspektet e hartimit të PLVM-së dhe gjetjes së mjeteve shtesë për realizimin e aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë mjedisore.

Në kuadër të projekti për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM), është bërë një anketim i qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës. Ka qenë një numër i konsiderueshëm i pyetësorëve, të cilët kanë ndihmuar dhe orientuar grupin në mënyrë më të drejtë në zgjedhjen e fushave prioritare. Një falënderim për këtë i takon qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës dhe shoqërisë civile, e cila në procesin e anketimit të respondentëve ka ndihmuar që procesi i anketimit të jetë i suksesshëm. Për të pasur një përfshirje sa më të gjerë dhe për të marrë mendimet e komunitetit dhe shoqërisë civile, janë organizuar edhe debate publike dhe debate në media.

Dokumenti i është paraqitur Kuvendit Komunal të Fushë-Kosovës dhe është miratuar prej tij më 18.06.2012, duke e kthyer atë në një dokument zyrtar pune. Për të ndihmuar procesin e zbatimit, një shumë investimesh të akorduara nga projekti do të përdoren për të zbatuar pjesë të Planit.

Procesi themelor i hartimit të PLVM-së ndahet në faza, të cilat lidhen njëra pas tjetrës:

- a) Nënshkrimi i marrëveshjeve dhe memorandumëve REC – Komunë;
- b) Aktivitetet përgatitore;
- c) Formimi i trupit koordinues TK;
- d) Formimi i grupit punues GP;
- e) Trajnimi i GP
- f) Vlerësimi i gjendjes së mjedisit;
- g) Anketimi i qytetarëve;
- h) Hartimi i vizionit të komunitetit;
- i) Caktimi i prioriteteve;
- j) Hartimi i planit të veprimit për fushat prioritare dhe;
- k) Caktimi i prioriteteve në realizimin e planit të veprimit.

Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:

1. Analiza e gjendjes mjedisore

Paraqet një analizim të hollësishëm të situatës për të gjitha çështjet e marra në konsideratë nga plani, duke e paraqitur atë në të gjitha aspektet e tij dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore, të cilat shqetësojnë Komunën e Fushë-Kosovës.

2. Lista e problemeve mjedisore

Problemet mjedisore paraqiten sipas një matrice të paracaktuar, e cila jep në mënyrë të detajuar të gjithë treguesit për identifikimin e një problemi. Pjesët më të rëndësishme të kësaj matrice janë shkaktarët e problemit dhe prioriteti për secilin.

3. Plani i veprimeve për zgjidhje

Ky kapitull është pjesa më e rëndësishme e Planit, pasi paraqet të gjitha veprimet dhe projektet e mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore të përcaktuara.

Kjo matricë u shërben autoriteteve vendore për të hartuar projektet konkrete dhe për sigurimin e fondeve nga donatorët.

VIZIONI

‘Fushë-Kosova është qendër urbane e zhvilluar ekonomikisht, mbrojtje mjedisore e avancuar, infrastrukturë të përparuar, qytet që rritet dhe mirëpret investitorët, në funksion të zbatimit të strategjive shtetërore për të gjitha komunitetet’.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E GJENDJES NE MJEDIS

Vlerësimi i gjendjes së mjedisit, gjatë kohës së hartimit të PLVM-së, është bërë në këto fusha:

Mbeturinat

Menaxhimi i mbeturinave paraqet një ndër shqetësimet më të mëdha për mjedisin dhe një barrë të madhe ekonomike për shoqërinë. Çështja e mbeturinave nënkupton edhe humbjen e resurseve. Pas gjenerimit mbeturinat duhet të mblidhen, trajtohen dhe mënjanoen dhe ky proces sërish involvon përdorim të resurseve dhe paraqet një rrezik potencial për ndotje. Puna me mbeturina ngërthen një mori problemesh mjedisore në shëndet, klimë dhe kontaminimin e ujërave, tokës dhe ajrit.

Për këtë arsye, Komuna e Fushë-Kosovës menaxhimin e mbeturinave e ka vendosë ndër prioritetet e saj, duke e mbështetur edhe në aspektin financiar, ekonomik dhe strategjik.

Uji

Kosova ka rezerva të kufizuara ujore, që në të ardhmen do të jenë faktorë kufizues për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Fushë-Kosova shfrytëzon ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, të cilat shfrytëzohen për pije dhe për ujitje. Në Komunën e Fushë-Kosovës ekzistojnë njëzetënjë (21) burime të ujit që shfrytëzohen për prodhim të ujit për pije. KUR në vitin 2011 ka nxjerr 2,918,508 m³.

Ajri

Ajri i pastër është me rëndësi vitale për shëndetin e njeriut. Kualiteti i ajrit që e thithim ka rënë konsiderueshëm, kryesisht, si rezultat i aktiviteteve njerëzore.

Ngritja e prodhimit industrial, djegia e karburanteve, si dhe rritja dramatike e trafikut, kanë shtuar edhe më shumë ndotjen e ajrit nëpër qytete. Si rrjedhim, kjo ndotje mund të shkaktojë probleme shëndetësore serioze, në të ardhmen.

Si problem kryesor në Fushë-Kosovë i ndotësve të ajrit është KEK-u, (Termocentralet A dhe B), por edhe objektet tjera private, si dhe komunikacioni. Ndotja kryesisht paraqitet në formë të emisioneve të dioksidit të sulfurit (SO₂), oksidit të azotit (NO), ozon (O₃), Plumb, dioksid karboni (CO₂), pluhur, grimca të patretshme dhe dioksin.

Ndotje e konsiderueshme e ajrit shkaktohet edhe nga trafiku transit rrugor, i cili kalon përmes vendbanimit dhe është mjaftë intensiv (në pikat kyçe kalojnë mbi 1000 automjete brenda një ore).

Përveç kësaj, edhe sektori i industrisë në shumicën e rasteve përdor pajisje të vjetra. Mungesa e energjisë elektrike dhe përdorimi i gjeneratorëve për kompensimin e saj, mungesa e sistemit për ngrohje qendrore, gjithashtu janë burime të cilat kontribuojnë për ndotjen e ajrit. Sektori i bujqësisë kontribuon në ndotjen e ajrit kryesisht përmes djegies së biomasës. Zonat ilegale për hedhjen e mbeturinave me djegie të pakontrolluara të mbeturinave paraqesin një burim serioz të ndotjes së ajrit.

Zhvillimi urban, shfrytëzimi i tokës/ave dhe karakteristikat e dheut - pozita gjeografike

Komuna e Fushë-Kosovës ndodhet tetë (8) kilometra në Jug-Perëndim të Prishtinës. Gjendet në mes këtyre koordinatave gjeografike 42.63° veri, 21.12° lindje. Sipërfaqja e përgjithshme është 9517.04 ha apo 84 km². Dendësia e popullsisë në km² është 420b/1km².

Në periudhën e pasluftës, Fushë-Kosova ka shërbyer si një pikë e grumbullimit për banorët që kishin synim afrimin drejt qytetit të Prishtinës. Ky ritëm do të vazhdojë edhe për dhjetë (10) vjetët e ardhshme.

Qyteti i Fushë-Kosovës disponon me Planin Urbanistik, të hartuar në vitin 2005 dhe është miratuar në po të njëjtin vit, me afat të vlefshmërisë deri në vitin 2011, është bërë revidimi në vitin 2012, i cili është aprovuar nga Kuvendi i Komunës në vitin 2012.

Kohë më parë nga Kuvendi i Komunës është miratuar Strategjia Zhvillimore Ekonomike Lokale (2011-2014). Po ashtu, është miratuar edhe Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturisë.

Fushë-Kosova ka sipërfaqe prej 84 km². Relievin e Komunës së Fushë-Kosovës e karakterizojnë hapësira të rrafshëta dhe kodrinore-malore.

Tipet e tokave:

- Tokë e kuqërremtë;
- Smonicë e pa karbonizuar;
- Smonicë në proces të kafenizimit;
- Smonicë e kafenizuar;
- Tokë livadh - argjilore;
- Tokë podzollake - pseudo;
- Tokë e kafenj të e cektë dhe mesatarisht e thellë;
- Tokë aluviale ranore, deltinore dhe e kafenizuar, dhe;
- Tokë e aplejuar mineralo - moçalike.

Destinimi i tokës:

Tokë për banim-986 ha, toka për biznes-2324 ha, toka për bujqësi-4511 ha, tokë për industri-235 dhe pyje-1619 ha.

Resurset natyrore dhe biodiversiteti

Një ndër instrumentet shumë të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit është mbrojtja e natyrës përmes zonave të mbrojtura. Në Komunën e Fushë-Kosovës zonë e mbrojtur është shpallë “Zona e Goleshit”, ku ndodhet kufiri më verior i përhapjes së bimës endemike të Kosovës “Forsythia Europea-Boshtra”.

Zonat e mbrojtura në Fushë-Kosovë

Emri i objektit: Bima endemike Forsythia Europea-Boshtra;

Viti i shpalljes: 2005;

Kategoria mbrojtëse: “Zonë me vlera të veçanta natyrore”;

Emri i objektit: “Kalaja e Harilaçit” dhe “Bardhit të Madh”;

Viti i shpalljes: 2007;

Kategoria mbrojtëse: Zona turistike.

Pjesa 2

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR KOMUNËN E FUSHË-KOSOVËS

2.1. Historiku

Fushë-Kosova është qytet që ka pozitë qendrore në Rrafshin e Kosovës, me një afërsi prej tetë (8) km nga kryeqyteti i Kosovës, Prishtina. Qysh herët, Fushë-Kosova, njihet si nyje hekurudhore nëpër të cilën ka kaluar rruga e lashtë ilire “Via-Ignatia”, që ka lidhur Bizantin me Kostandinopojën.

Fushë-Kosova ka kushtet e mira natyrore, pozitën e mirë gjeografike dhe kushtet e përshtatshme klimatike për zhvillimin e gjuetisë, blegtorisë, bujqësisë dhe më vonë edhe të degëve të tjera, si dhe relievit që mundësonte sigurinë. Lokaliteti i këtij vendbanimi ishte i banuar që nga kohët më të lashta nga banorët vendas iliro-dardanët, shek. VIII p.e.s. (Bardhi i Madh), neoliti (Harilaçi), etj., pastaj koha antike e mesjetare, si Ulari (Uglari), Kumanova (afër Vragolisë), Bardhi i Vogël, Harilaçi etj. Këtë e dëshmojnë gjetjet e shumta arkeologjike në lokalitetet e kësaj Komune.

Territori i Sllatinës, së dikurshme e më gjerë, banohej qysh nga kohët më të lashta, nga Ilirët, ku është bërë edhe gërshetimi i kësaj treve me vendbanimet e vjetra antike, si “Harillaçi”, “Bardhoshi”, “Maja e Zezë” etj. Në këtë territor afër varrezave gjendet një vend ku supozohet se është “tumë ilire”. Gjatë punimit të tokës dhe punëve ndërtimore nga banorët vendas, sidomos në pjesën jugore të fshatit, janë gjetur gjurmë të llojllojshme të kulturës materiale, si themele me gurë të ndërtesave, tulla të pjekura të formatit të madh, pjesë të qeramikës, copa të metalit, rrugë të shtruara me gurë, pusa të ujit etj., që dëshmojnë se aty ekzistonte vendbanim shumë i hershëm. Në shekullin e vjetër me depërtimin e krishterimit filloi ndërtimi i faltoreve - kishave. Në pjesën juglindore të Sllatinës së Vogël ishte ndërtuar kisha, ku sot njihet si “Të kisha dhe Arat e kishës”. Bardhi i Madh i takonte grupit kulturor dardan, shek. VIII-IV p.e.s. ky lokalitet sot quhet me emrin Kala. Kalaja e Bardhit gjendet mbi një kodër të ulët, që ngrihet mbi fshat, afër lumit “Drenicë”, që përmbi fusha pjellore. Kalaja ka trajtë trapezoide. Në anën lindore dhe atë verilindore të Kalasë gjenden gjurmët e mureve mbrojtëse, të mbuluara tani me humus. Në jug të Kalasë ekzistojnë varreza të moçme, mjaft të gjata (nuk ka hulumtime). Ka shumë gjurmë arkeologjike të gjetura në pjesën jugperëndimore të fshatit, në bregun e majtë të Drenicës, gati deri te fshati Mesbardh, si themele të shtëpive.

Në pjesën jugore të fshatit, që quhet “Qeremidhanja”, shihen gjurmët e vendbanimit të vjetër. Këtu përveç themeleve të shtëpive, gurëve, tullave, tjegullave etj., janë gjetur edhe monedha të moçme.

Në anën veriore të fshatit, në lokalitetin “Arat e Kishës”, janë gjetur dyert e derës hyrëse të kishës, pastaj ka tjegulla, suvatim i bardhë, etj. Gjurmimet arkeologjike në territorin e Komunës dëshmojnë për lashtësinë e këtij lokacioni, si vendbanim.

Janë të evidentuara ndërtesa me rëndësi historike në: Harilaç, Kalaja e Vjetër në Bardh të Madh

dhe disa objekte fetare në qytet, Sllatinë të Madhe dhe Bresje. Kohëve të fundit janë identifikuar po ashtu disa varreza me rëndësi historike në Gurshkabë, që kanë rëndësi historike, jo vetëm për Komunën, por edhe për Kosovën në tërësi, që verifikojnë lashtësinë e kësaj treve.


Edhe pse e njohur si vendbanim, që herët, Fushë-Kosova, si Komunë u konsolidua, mjaft vonë, në vitin 1989. Njihet si Komunë multietnike, ku banojnë komunitete të ndryshme, krahas shumicës shqiptarë.

2.2. Pozita gjeografike


Fushë-Kosova është Komunë që shtrihet në qendër të Rrafshit të Kosovës, me një sipërfaqe prej 84 km² dhe me një lartësi mbidetare 530-550m. Në lindje kufizohet me Komunën e Prishtinës, në veri me Komunën e Kastriotit, në Jug me Komunën e Graçanicës, ndërsa në perëndim kufizohet me Komunën e Drenasit. Ajo përbëhet prej gjashtëmbëdhjetë (16) vendbanimeve. Gjendet në zonën e kryqëzimit të rrugëve me rëndësi për transport, si ajo hekurudhore që lidhë Fushë-Kosovë - Shkupin e Mitrovicën, që pastaj lidhet me rrugët ndërkombëtare. Po ashtu, ajo ndodhet në kryqëzim të magjistrave të rëndësishme. Në territorin e saj gjendet edhe Aeroporti Civil Nderkombëtar i Prishtinës. Në vazhdim janë dhënë disa statistika të rëndësishme për Komunë:

- **Sipërfaqja** - 84km² (0.91 % të territorit të Kosovës);
- **Lartësia mbidetare** - 530- 550m;
- **Klima** - Kontinentale e mesme kontinentale;
- **Të reshurat atmosferike** - 628mm /vit;
- **Temperatura** - Muaji më i ftohtë është janari, ndërsa më i ngrohti gushti;
- **Temperatura** - mesatare vjetore është 9.8 °C.

Komuna e Fushë-Kosovës ka të regjistruar 14.19 % tokë të ndërtuar (urbane), 54.35 % tokë bujqësore (rurale), pyje 13.63 %, djerrinë 1.6 %, deponi pasive hiri 10.26 %, industri 5.47 % dhe deponi aktive hiri 0.5 %.



Harta 1. Fushë-Kosova në hartën e Republikës së Kosovës



Harta 2 Komuna e Fushë-Kosova në rajon të gjërë - organizimi administrativ

2.3. Ndarja administrative e territorit të Komunës së Fushë-Kosovës

Komuna e Fushë-Kosovës ka gjashtëmbëdhjetë (16) vendbanime, ato janë: Graboc i Ulët, Bardhi i Madh, Pomozotin, Bardh i Vogël, Sllatinë e Vogël, Sllatinë e Madhe, Harilaç, Henc, Vragoli, Miradi e Poshtme, Miradi e Epërme, Kuzmin, Lismir, Fushë-Kosovë, Nakradë dhe Bresje.

2.4. Karakteristikat gjeologjike

Komuna e Fushë-Kosovës në aspektin gjeologjik i takon pjesës qendrore të rrethit lindor të Basenit të Kosovës. Baseni është i formuar në shkëmbinjtë të vjetërsisë-neogjen, me shpërndarje të gjerë të serisë së thëngjillit. Në bazë të kësaj serie neogjenë në mënyrë të qartë bëhet ndarja e bazës, shtresa e thëngjillit dhe fundërrina. Në sajë të bazës mund të veçohen dy (2) horizonte litologjike: 1. Horizonti i poshtëm -përbëhet nga rëra, ndërsa, 2. Ai i sipërm - nga rëra argjilore, ngjyrë hiri në të gjelbër. Shtresa e thëngjillit përbëhet prej linjiteve me shtresa të holla të djerrinës. Shtresa fundërrinore përbëhet nga argjila ngjyrë hiri me grimca vende-vende të gëlqeres. Në pjesë të caktuara të terrenit shtresa fundërrinore) përmbi shtresën e thëngjillit shtrihet direkt në formimet aluviale. Pjesët sipërfaqësore të terrenit i krijojnë shtresat aluviale. Formësimet aluviale janë të përbëra me argjilë ranoro-pluhurore, me rërë të kokërrimët dhe vende-vende me përmbajtje më të madhe të fraksioneve të zhavorrit.

2.5. KLIMA

Komuna e Fushë-Kosovës ndodhet në Basenin e Kosovës, i cili është në fushën e Ibrit në veri dhe në fushën e Llapit - Toplicës, në veri-lindje, i hapur ndaj ndikimeve veriore - kontinentale - klimatike. Dimri është i ftohtë, ndërsa vera është e ngrohtë dhe e thatë. Baseni i Kosovës, për shkak të kufizimeve me male të larta në jug dhe perëndim janë të privuara nga masat ajrore të Detit Adriatik dhe Detit Egje. Në rajonin e Komunës së Fushë-Kosovës janë përpunuar të dhënat meteorologjike për dy stacione.

Lartësia mbidetare e stacioneve të përpunimit është: Prishtinë 573m, Lismir 540m. Rajoni i analizuar është homogjen orografik, lartësia mbidetare e territorit është në intervalin prej 500 -600m.

Parametrat meteorologjike që varen nga lartësia mbidetare janë: temperatura e mesme vjetore e ajrit bie me rritjen a lartësisë mbidetare, ndërsa sasia e të reshurave vjetore rritet.

Numri i ditëve vjetore me borë, si dhe numri i ditëve me shtresë të borës rritet varësisht nga lartësia mbidetare, ndërsa parametrat tjerë meteorologjikë varen nga kushtet lokale mikroklimatike.

2.5.1. Temperatura e ajrit

Temperatura e mesme vjetore e ajrit në rajonin e hulumtuar është 9,7°C, muaji më i ftohtë është janari, me temperaturë mesatare të ajrit rreth 1,0°C, korriku është më i ngrohti, me temperaturë 19,3°C. Muaji tetor është më i ngrohtë se prilli.

2.5.2. Era

Është e kushtëzuar nga faktorët e ndryshëm, kështu që dendësia e drejtimeve të përshkuara dhe shpejtësia kanë karakter lokal të kushtëzuar nga karakteri orografik i vendit. Era më e shpeshtë është ajo verilindore, kurse shpejtësinë mesatare më të madhe e ka era veri-verilindore 3.7 m/s.

2.5.3. Lagështia relative e ajrit

Lagështia relative mesatare vjetore e ajrit është në intervalin prej 71,4 %, maksimumi është në dhjetor 84 %, ndërsa mesatarja minimale në korrik 63 %. Vlera mesatare vjetore e shtypjes së avullit të ujit është 9,5 mb, maksimumi është në korrik 14,4 mb, ndërsa minimumi është në janar 5,0 mb.

2.5.4. Të reshurat

Shuma mesatare vjetore e të reshurave në rajon sillet prej 620,6mm deri në 617,4mm. Lartësia e të reshurave mujore maksimale mesatare është në maj dhe qershor, maksimumi sekondar është në nëntor, ndërsa minimumi më së shpeshti është në muajin mars.



Harta 4. Harta meteorologjike

2.6. Karakteristikat hidrologjike-lumenjtë

Territorin e Fushë-Kosovës e përshkojnë tri rrjedha të lumenjve: lumi “Sitnicë”, i cili gjendet në kufi të rajonit, lumi “Prishtevkë” me rrjedhën e poshtme të saj dhe “Përroi i Njelmët”. Karakteristikat e përgjithshme të drejtimit të rrjedhave janë prerja e dobët e lugut dhe inundacioni i rrafshit të gjerë në raport me sasinë e ujit dhe pjerrtësinë e bregut. Për nga gjatësia e rrjedhës dhe sipërfaqes ujëmbledhëse lumi “Sitnicë” është rrjedhja më e madhe e Ibrit (35.5 % sipërfaqes së përgjithshme të ujëmbledhëse dhe 22,4 % sasisë rrjedhëse). Karakteristika e shprehur e rrjedhës së lumit “Sitnicë” është fluktuacioni (luhatja) i madh i nivelit të ujit, kështu që zgjedhja optimale e profilit për rregullimin e shtratit të lumit është e vështirësuar. Profili natyror i shtratit të lumit është mjaft stabil, ndërsa rënia gjatësore e shtratit është e madhe, pa thyerje të shprehura. Valët vërshuese janë më frekuentive në periudhën më të ftohët të vitit. Shtrati i lumit “Sitnicë” ka qenë i rregulluar 5 km. në drejtim të rrjedhës prej Fushë-Kosovës kah Obiliqi. Profili i rregulluar ka qenë i gjerësisë 160 m. thellësisë 3m. Përqindja e gjerësisë së shtratit të parregulluar përgjatë Fushë-Kosovës ka qenë rreth 30m. Lumi “Prishtevkë” është degë e djathtë e lumit “Sitnicë”. Pjesa e rregulluar shërben si recipient i ujërave atmosferike për Prishtinën, ku në pjesën më të madhe rrjedh si kanal i mbyllur. Në pjesën më të madhe rreth Fushë-Kosovës shtrati është i parregulluar dhe ashtu si është kalon nën rrugën Pejë-Prishtinë. “Përroska e Njelmët” është degë e “Sitnicës” dhe shtrati i saj është në një pjesë (në gjatësi

rreth 700m) e vendosur në tuba të betonit \varnothing 1000mm deri të rruga “Vëllezërit Janković”. Kjo rrjedhë është recipient i ujërave atmosferike në hapësirat ku përfshihet edhe “Kompleksi 300 - banesat”. Lumi “Sitnicë”, në të gjitha rrjedhat e tij, është i varfër me ujë, në pjesën më të madhe të vitit, në të derdhen ujërat e zeza dhe atmosferike të lokaliteteve të cilat shtrihen përreth lumit. Është i nevojshëm të bëhet pastrimi i ujërave teknologjikë dhe sanitarë, para derdhjes së kanalizimit në shtratin e lumit “Sitnicë”.



Harta 3. Harta hidrologjike

2.7. BURIMET E UJIT

Momentalisht në Komunën e Fushë-Kosovës ekzistojnë njëzetënjë (21) burime të ujit që shfrytëzohen për prodhim të ujit për pije. Të gjitha këto sisteme për furnizim me ujë shfrytëzojnë ujërat nëntokësore.

Kompania e Ujësjetës Rajonal “Prishtina” në vitin 2011 ka nxjerr $2.918.508\text{m}^3$ nga 19 burime nëntokësore/puse. Burimet kryesore të ujit janë nga pusët e njohura me emrin “Pusët e Kroit”, në Kuzmin, “Pusët në Vragoli”, si dhe një “Pusi në Miradi të Poshtme”. Dy burime tjera nëntokësore operohen nga Komuniteti lokal në Henc dhe Harilaç.

2.7.1. Gjendja fizikio-kimike e ujërave

Në lidhje me përbërësit kimikë, uji nëntokësor, nga shumica e mostrave, i plotëson kërkesat sipas standardit të Institutit të Shëndetit Publik të Kosovës (ISHPK). Gjatë periudhave të dimrit vërehet turbullira në ujë, si dhe një sasi e vogël e rërës.

2.7.2. Gjendja bakteriologjike

Të gjitha mostrat e ujit kanë tejkaluar standardet e kualitetit të ujit, sipas ISHPK-së. Brenda vitit 2011 nga ana e KUR-it janë realizuar 356 testime të ujit dhe atë në çdo pus një (1) testim brenda 24 orëve.

2.8. KARAKTERISTIKAT PEDOLOGJIKE

Në rajonin e Komunës së Fushë-Kosovës veçohet tipi i dheut aluvial. Fluvisoli (aluviumi) bënë pjesë në klasën e dherave fluviatile dhe fluviogleje.

Gjeneza e fluvisolit dhe veçoritë e saj janë të kushtëzuara me drejtimin hidrologjik të lumit dhe materialit natyror, i cili sedimentohet (rëra, zhavorri). Për këtë arsye, profili i fluvisolit karakterizohet me shtresim të theksuar. Pa marrë parasysh që fluvisoli i takon dherave të pazhvilluara, ato zakonisht kanë plleshmëri të madhe. Në këtë tokë mund të kultivohet plepi, si dhe perimet. Janë dhera të përshtatshme për livadhe.

Kjo tokë renditet në klasën e III-të të bonitetit.

Ndër tipat pedologjike të tokave të cilat janë më të përfaqësuara në Komunën e Fushë-Kosovës janë: Vertisol (smonicë), rreth 35 %, Fluvisol (aluviale), rreth 27 %, Kambike (tokat e kuqe kafeje), rreth 25 %. Vertisol (smonicë) Sipërfaqet e tokës bujqësore që bëjnë pjesë në këtë tip të tokave kryesisht shtrihen në fshatrat: Bardh, Lismir, Kuzmin, Vragoli, Miradi e Poshtme dhe Henc.

2.8.1. Tokat aluviale (fluvisol)

Sipërfaqet e tokës bujqësore që bëjnë pjesë në këtë tip të tokave, kryesisht shtrihen në fshatrat: Nakër, Lismir, Kuzmin, Vragoli, Bardh i Vogël, Bardh i Madh, Miradi e Poshtme dhe në qytetin e Fushë-Kosovës. Vlera mesatare e reaksionit aktiv të tokës (pH në H₂O) mesatarisht është 7.5pH, por ajo luhet në mes pH 6.7-7.8.

2.8.2. Tokat e kuqe - kafeje (kambike)

Sipërfaqet e tokës bujqësore që bëjnë pjesë në këtë tip të tokës janë ato të fshatrave: Gurshkabë, Bardh i Madh, Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël. Vlerat e reaksionit aktiv të tokës (pH në H₂O) mesatarisht është 7.06pH, me luhetje nga pH 4.6 deri 8.4.

2.8.3. Klasa e tokës

Tokat i takojnë klasës së tokave argjilore, lymore-ranore-argjilore, lymore-pluhurore-argjilore dhe lymore-argjilore.

2.9. POPULLSIA

Popullsia e Fushë-Kosovës për vitin 2008 numëronte (sipas një regjistrimi të brendshëm) rreth 40.000 banorë, me një ndarje për meshkuj dhe për femra. Në bazë të analizave statistikore shihet se për çdo vit kemi shtim të numrit të banorëve, jo vetëm nga nataliteti, por edhe nga ardhja e banorëve të rinj nga zonat e Kosovës Lindore dhe nga viset e tjera të Kosovës.


Tabela 1. Numri i banorëve sipas vendbanimeve në Komunën e Fushë-Kosovës

| | 1948 | 1953 | 1961 | 1971 | 1981 | 1996 | 1999 | 2001 | 2008 |
|------------------|-------------|-------------|-------------|--------------|---------------|-------------|---------------|---------------|-------------|
| Fushë- Kosovë | 275 1344 | 422 1792 | 736 2190 | 1831 8450 | 2679 13464 | -- | 1060 13278 | 1395 14000 | -- 15250 |
| Nakradë | 12 82 | 15 89 | 38 269 | 91 665 | 146 1139 | -- | -- 3278 | -- | -- 1250 |
| Sllatinë e Madhe | 96 621 | 109 692 | 134 842 | 188 1267 | -- 1576 | 350 2229 | -- 2587 | 287 2500 | -- 2500 |
| Sllatinë e Vogël | 21 125 | 23 164 | 28 204 | 43 302 | 60 487 | 65 596 | -- | 94 650 | -- 650 |
| Bardh i Madh | 167 1177 | 180 1290 | 192 1545 | 305 2260 | 343 2831 | -- | -- 4132 | 750 3500 | -- 4200 |
| Graboci | 82 571 | 86 652 | 89 679 | 137 878 | 170 1169 | -- | -- 1213 | 224 1270 | -- 2000 |
| Harilaçi | 49 304 | 57 334 | 63 411 | 83 547 | 79 624 | -- | -- | 87 956 | -- 1000 |
| Henci | 332 227 | 30 246 | 53 363 | 62 459 | 69 577 | -- | -- | 100 760 | -- 700 |
| Kroi | 61 415 | 72 465 | 85 516 | 98 502 | 102 536 | -- | -- | 75 300 | -- 300 |
| Lismiri | 57 538 | 73 607 | 76 731 | 105 921 | 127 1055 | -- | -- | 192 1250 | -- 900 |
| Vragolia | 50 400 | 60 435 | 70 550 | 99 787 | 129 1086 | -- | -- | 230 1600 | -- 1700 |
| Pomozotini | 36 174 | 35 188 | 41 218 | 54 319 | 73 455 | -- | -- | 106 700 | -- 800 |
| Miradi e Epërme | 96 565 | 97 612 | 130 778 | 184 1130 | 204 1339 | -- | 240 -- | 216 2170 | -- 1800 |
| Miradi e Poshtme | 44 322 | 51 419 | 71 555 | 131 838 | 139 1116 | -- | 280 1600 | 300 2000 | -- 2000 |

2.9.1. Struktura e popullsisë

Struktura sipas moshës në Komunën e Fushë-Kosovës

Pjesëmarrja e popullsisë me grup-moshë mbi vitin 1989 është me 35 %, mbi vitin 1939 është 60 % dhe nën vitin 1939 është 5 %.




Diagrami 1- Struktura e grup-moshave

Grup-moshat:

1. Mbi vitin 1989 / Deri 25-vjet
2. Mbi vitin 1939 / Deri 50-vjet
3. Nën vitin 1939 / Mbi 50-vjet

2.9.2 Struktura gjinore

Në Komunën e Fushë-Kosovës, sipas burimit nga Këshilli Komunal i Fushë-Kosovës, struktura gjinore është:



Diagrami 2 - % e popullsisë sipas gjinisë

Meshkuj: 15122 ose 52 %;

Femra: 13785 ose 48 %.

(Burimi: Zyra për Informim, Komuna e Fushë-Kosovës)

2.9.3. Struktura etnike

Në Komunën e Fushë-Kosovës jetojnë kryesisht banorë shqiptarë, mirëpo në territorin e kësaj Komune jetojnë edhe pjesëtarë të komunitetit serb, rom, ashkalinj etj.


Përmbajtja e strukturës kombëtare për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës është si vijon.

Tabela 3. Struktura etnike në Komunën e Fushë-Kosovës

| Përbërja etnike | | | | | | | | | | | |
|-----------------|-----------|----|-------|----|------------|-----|------|-----|----------|------|--------|
| Viti/Etnia | Shqiptarë | % | Serbë | % | Ashkalinjë | % | Romë | % | Të tjerë | % | Total |
| Korrik 2000 | 34,000 | 84 | 4,000 | 10 | 2,600 | 6.4 | 300 | 0.7 | 60 | 0.14 | 40,500 |
| Prill 2008 | 34,000 | 85 | 3,239 | 8 | 2,259 | 5.6 | 388 | 1 | 21 | <0.5 | 40,000 |

Diagrami 3. Struktura etnike në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Shqiptarë
2. Serbë
3. Ashkalinjë
4. Romë
5. Të tjerë



2.10. EKONOMIA

Në të kaluarën (sidomos në fillim të viteve të '70-ta) janë ndërtuar kapacitete prodhuese industriale të cilat kanë qenë gjeneratorë të zhvillimit ekonomik të Komunës dhe punësimit. Fabrikat kryesore ishin: Industria e Miellit dhe e Bukës "Mulliri"; Fabrika e Bukës dhe Ëmbëlsirave "Kosovarja", Ndërmarrja Hekurudhore Transportuese Fushë-Kosovë dhe Aeroporti i Prishtinës.

Zhvillimi i disa degëve industriale, kryesisht ka qenë i stimuluar nga përparësia konkurruese e Komunës dhe toka pjellore për prodhimin e disa produkteve bujqësore si: Ferma për Majmërinë e Viçave, Ferma e Derrave, Fabrika e Ushqimit Blegtoral, Fabrika për Përpunimin e Mishit, Fabrika e Konfeksionit të Rëndë "Yumko" etj. Po ashtu, në Komunën e Fushë-Kosovës shtrihen rezerva të mëdha të qymyrit-linjit që furnizojnë Termocentralet në Kastriot për prodhimin e energjisë elektrike. Kompania Mihja Sipërfaqësore funksionon edhe sot dhe është një burim i rëndësishëm i punësimit për Komunën.

Fushë-Kosova, e krijuar si Komunë në vitin 1988, është zhvilluar shumë, sidomos në dhjetë (10) vjetet e fundit, pas përfundimit të luftës. Kohëve të fundit, një pjesë e madhe e Fushë-Kosovës është shndërruar në "Zonë Industriale", ku janë përqendruar shumë biznese, jo vetëm nga Prishtina, por edhe nga anë tjera të Kosovës. Kjo ka ndikuar që Fushë-Kosova të kthehet në një qendër biznesi shumë të rëndësishme për tërë Kosovën.

Që nga viti 1999, kushtet zhvillimore për Komunën se Fushë-Kosovës kanë ndryshuar rrënjësisht. Fushë-Kosova sot ka rastin të shfrytëzojë me kapacitet të plotë të gjitha mundësitë që dalin nga pozita e saj gjeografike dhe infrastruktura e saj e cila është më afër qytetit të Prishtinës, lokacionit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës dhe Hekurudhave të Kosovës, kufijve të Komunës dhe nyja rrugore që duhet të vlerësohen si asete madhore për zhvillim. Si rezultat i kësaj gjendjeje, Fushë-Kosova tanimë ka pasur përvojën e kërkesave të shumta për nevojë të tokës industriale dhe komerciale, e po ashtu edhe për tokë banimi.

2.10.1. Numri dhe Struktura e Bizneseve

Sektori Privat

Nga të dhënat e regjistrit të bizneseve (korrik 2010) vërehet qartë dominimi i ndërmarrjeve tregtare dhe shërbyese. Një strukturë e tillë i përgjigjet edhe strukturës së bizneseve private, sipas sektorëve në nivel të Kosovës. Në anën tjetër, pjesëmarrja e bizneseve prodhuese mbetet shumë e ulët, së bashku me ndërtimtarinë dhe sektorin e bujqësisë.

Tregtia me pakicë dhe shumicë paraqet pjesën kryesore të ekonomisë së Komunës së Fushë-Kosovës. Aktualisht, dominojnë shitësit e vegjël, me më pak se 50m² sipërfaqe për shitje, që veprojnë në qytete dhe fshatra të Komunës. Grupime të shitoreve do të mund të gjendeshin në fshatra me vetëm disa qindra banorë.

Fokusi i shitjeve të produkteve të ndryshme është Fushë-Kosova (qyteti). Sipas shënimeve nga tabela nr. 1, struktura ekonomike në Fushë-Kosovë është e dominuar me ndarjen e ndërmarrjeve të vogla që kanë më pak se dhjetë (10) punëtorë, që përbëjnë kufij të vegjël në shitjen e prodhimeve standarde ose shërbime. Vetëm një pjesë e vogël e NVM ofrojnë prodhime të sofistikuar dhe shërbime. Në të shumtën e rasteve NVM janë firma familjare që involvojnë investime të vogla të kapitalit.

Tabela 4. Bizneset sipas veprimtarive (2010)

| Veprimtaritë | Numri i bizneseve | |
|--------------|-------------------|---------|
| | 2011 | % |
| Tregtare | 365 | 37.86 % |
| Shërbyese | 536 | 55.60 % |
| Prodhuese | 25 | 2.59 % |
| Ndërtimore | 14 | 1.45 % |
| Bujqësore | 2 | 0.21 % |
| Të tjera | 22 | 2.28 % |
| Gjithsej | 964 | 100 % |

Nga të dhënat e regjistrit të bizneseve (2011) vërehet qartë dominimi i ndërmarrjeve shërbyese (55.6 %) dhe tregtare (37.86 %). Një strukturë e tillë i përgjigjet edhe strukturës së bizneseve private, sipas sektorëve në nivel të Kosovës. Në anën tjetër, pjesëmarrja e bizneseve prodhuese mbetet shumë e ulët, së bashku me ndërtimtarinë dhe sektorin e bujqësisë të cilat së bashku përfaqësojnë 4.25 % të numrit të përgjithshëm të bizneseve private në Komunë.

2.11. Bujqësia dhe Blegtoria

Bujqësia me degët e saj mbetet akoma ndër burimet e rëndësishme të aktivitetit ekonomik të Komunës. Pjesa më e madhe e territorit të Komunës është tokë bujqësore (60 %), që vështruar nga aspekti i shfrytëzimit të hapësirës, paraqet një potencial jashtëzakonisht të madh të zhvillimit të bujqësisë, e cila mund të jetë në funksion të rritjes së punësimit dhe burimit të jetesës për popullatën që jeton në ambientet rurale. Qysh në kohën e ish-Jugosllavisë, Fushë-Kosova ka qenë e njohur për zhvillimin e bujqësisë dhe për ndërlidhjen e saj me industrinë për përpunimin e prodhimeve bujqësore (drithëra, qumështit dhe mishit).

2.12. Turizmi dhe Hoteleria

Një numër i rrugëve magjistrale që kryqëzohen në Fushë-Kosovë, duke përfshirë këtu komunikacionin ajror, hekurudhor dhe atë automobilistik, e bëjnë më shumë atraktiv këtë sektor. Aktualisht, në Komunën e Fushë-Kosovës ekzistojnë tetë (8) hotele dhe një numër i madh i moteleve të pajisura me objekte përcjellëse, të cilat ofrojnë ushqim dhe komoditet cilësor.

Tabela 5. Numri i hoteleve dhe i dhomave gjatë vitit 2008-2009

| Nr. ren. | Numri i hoteleve | Numri i dhomave | | | | | |
|----------|------------------|-----------------|----------------|-----------------|-------------|-----------|------------|
| | | Me një shtrat | Me dy shtretër | Me tre shtretër | Apartamente | Rezidenca | Gjithsejtë |
| 1 | 8 | 44 | 66 | 6 | 3 | 1 | 120 |

Tabela 6. Numri i vizitorëve (vendorë dhe të jashtëm) gjatë vitit 2008 dhe 2009

| Nr. ren. | 2008 | 2009 | TM/1-09 | TM/2-09 | TM/3-09 | TM/4-09 |
|----------|------|------|---------|---------|---------|---------|
| 1. | 1123 | 2318 | 648 | 431 | 357 | 882 |

2.12. Komuniteti i Biznesit

Komuniteti i biznesit në Komunë nuk është i kënaqshëm. Qeveria komunale është e angazhuar në mbështetjen dhe organizimin e këtij komuniteti, me qëllim të ndërtimit të një partneriteti më të gjerë në mes komunitetit të biznesit, shoqërisë civile dhe Komunës. Ky partneritet do t'i shërbente adresimit më adekuat të nevojave dhe barrierave me të cilat ballafaqohen bizneset.

2.13. INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE

2.13.1. Ujësjellësi

Fshatrat e Fushë-Kosovës janë të shtrira në një pjesë të pellgut të lumit “Sitnicë”, “Drenicë” në drejtim të rrjedhës së lumit “Sitnicë”, i cili është edhe baseni kryesor i ujërave nëntokësore. Nga ky pellg ku ekzistojnë edhe fusha e puseve nëntokësore, e quajtur “Kron”, ku i bëhet përpunimi i ujit të pijes që shërben për furnizimin e popullatës e cila jeton në qytetin e Fushë-Kosovës, i cili, pas kryeqytetit, ka rritjen më të lartë të popullsisë. Furnizimi i këtyre lokaliteteve pothuajse 90 % merr shërbime në furnizim të ujit të pijes, i cili ka një furnizim të kënaqshëm me një perspektivë më të mirë në të ardhmen. Nga fshatrat e Fushë-Kosovës të cilat nuk janë të përfshira në sistemet e furnizimit janë Sllatina e Madhe dhe Sllatina e Vogël.

Fshati Harilaç, i cili gjendet në pjesën Jugperëndimore të Fushë-Kosovës, ka të ndërtuar infrastrukturën e rrjetit të ujësjellësit që nuk menaxhohet nga KUR “Prishtina” SH. A, pasi që në atë pjesë nuk ka furnizim nga sistemet e furnizimit me ujë të Kompanisë. Rrjeti i furnizimit me ujë është rrjet i hapur dhe kryesisht është nga materiali PVC dhe PE. Linjat kryesore në drejtim të Bardhit të Madh, Bardhit të Vogël, Mesbardhit dhe Grabocit janë nga materiali PVC Ø225mm, Ø 110mm, PN-10Bara, AC-150mm, po ashtu në drejtim të Vragolisë janë nga materiali PVC Ø225mm PN-10Bara. Linjat në drejtim të Miradisë së Epërme dhe Miradisë së Poshtme janë nga materiali PVC Ø160mm. Fshati Miradi e Epërme është duke u furnizuar nga Liqeni i Badovcit, pasi nga Kroni furnizimi shkon deri në hyrje të fermës.

Rrjeti sekondar në këto fshatra është nga materialet PVC dhe PE, me diametër Ø75mm, Ø63mm, Ø50mm, Ø42mm, Ø32mm dhe Ø25mm.

2.13.2. Kanalizimi dhe ujërat e zeza

Të gjitha fshatrat kanë rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza, përpos Grabocit të Ulët, Harilaçit, Sllatina e Madhe, Sllatina e Vogël. Një pjesë e fshatrave që janë pranë Sitnicës, ujërat e zeza i derdhin në lumin “Sitnicë” pa kurrfarë trajtimi paraprak, duke munguar edhe gropat septike dhe pjesa tjetër derdhin ujërat e zeza në lumin “Drenicë”, i cili po në këto lokalitete bashkohet me lumin “Sitnicë”, i cili derdhet në lumin “Tbër”, ndotësi më i madh i lumit “Sitnicë” në pjesën e këtyre fshatrave është edhe lumi “Prishtevkë”, një përroskë e vogël e cila vjen nga pjesa lindore dhe së bashku transporton ujërat e zeza të kryeqytetit - Prishtinës.

2.13.3. Rrjeti i kanalizimit i ujërave të bardha

Kryesisht mungon në Komunën e Fushë-Kosovës.

2.13.4. Infrastruktura rrugore në rajonin e Fushë-Kosovës

Qyteti i Fushë-Kosovës, duke përfshirë edhe rajonin e kësaj Komune, gjendet përfaqësisht në qendër të Kosovës. Për shkak të kësaj pozite qendrore, qyteti ka rëndësi të veçantë gjeografike. Nëpër qytetin e Fushë-Kosovës kalojnë rrugët përmes së cilave Kosova lidhet me vendet e rajonit dhe me Evropën. Rrugët në të cilat zhvillohet komunikacioni më i dendur është Rruga Magjistrale - M9, e cila lidhë Prishtinën me Pejë dhe në vazhdim me Podgoricën (Mali i Zi). Gjithashtu, kjo rrugë në pjesën lindore të qytetit, kryqëzohet me rrugën tjetër Magjistrale M2, e cila është e një rëndësie të veçantë, sepse lidhë Kosovën me tërë rajonin. Bazuar në të dhënat e numrit të automjeteve, qarkullimi është rritur dukshëm.

Kjo rritje mund të shpjegohet, në masë të caktuar, me ndërrimin e regjimit të qarkullimit në pjesët e ndryshme të qytetit, si rezultat i zhvendosjeve të pakontrolluara nga pjesët rurale në ato urbane, i rritjes së shkallës së motorizimit, shërbimeve të dobëta dhe jo të mjaftueshme të automjeteve për transportin publik të udhëtarëve etj., ndërsa problem të veçantë paraqet edhe karakteri i kësaj rruge (rrugë më shumë shirita urbane me karakter të rrugës nacionale).

Në mungesë të numrit të saktë të automjeteve, për rajonin e Fushë-Kosovës, shkalla e motorizimit dhe struktura e automjeteve për këtë rajon mbetet e paqartë. Sipas të dhënave të mëhershme mbi numrin e automjeteve, shkalla e motorizimit ishte 1 automjet për 15,9 banorë.

Ndërsa, derisa numri i popullatës është rritur, rreth 40.000 banorë, dhe duke marrë shkallën e rritjes së motorizimit në tërë vendin, ky raport ka ndryshuar dukshëm.

Nga të dhënat e Drejtorisë së Rrugëve të Kosovës për periudhën 31 janar 2010, rrjedhë se numri i automjeteve, për 12 orë (07-19), në rrugën Magjistrale M9, sillet rreth 13.000 automjete.

2.13.5. Transporti publik

Për shkak të pozitës dhe lidhjes së afërt me qytetin e Prishtinës, qyteti i Fushë-Kosovës është i përfshirë në transportin urban të udhëtarëve. Trafiku urban kryesisht lidhet me qytetin e Prishtinës në intervale optimale, duke filluar nga ora 6.00 deri rreth orës 22.00. Intervali dhe frekuenca e përçjelljes (bazuar në orarin e udhëtimit nga TU), i përmbushë kërkesat për lëvizjen e udhëtarëve në këtë relacion.

Gjithashtu, lidhja e qytetit të Fushë-Kosovës me fshatrat përreth, mundësohet përmes trafikut ndër-urban (Prishtinë -Fushë Kosovë-Miradi e Epërme, Graboc-Fushë Kosovë-Prishtinë, Harilaç-Fushë -Kosovë-Prishtinë).

2.13.6. Komunikacioni hekurudhor

Hekurudhat e Kosovës gjenden në një situatë mjaft të vështirë. Infrastruktura hekurudhore (binarët, ndërtesat e stacioneve, stabilimentet sinjalizuese, telekomunikuese dhe të energjetikës), pas-taj operimet hekurudhore (lokomotivat, vagonët e udhëtarëve dhe ata të mallrave, punëtoritë etj.),

kërkojnë investime të mëdha, angazhim maksimal të të gjithë punonjësve, stafit menaxhues dhe autoriteteve tjera përgjegjëse, në mënyrë që të përmirësohet situata ekzistuese.

REKOMANDIMET:

- Hartimi i Planit lokal për mbrojtjen e ajrit nga ndotësit;
- Rrugë alternative transite për shmangie nga vendbanimet urbane;
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore;
- Monitorimi i cilësisë së ajrit dhe;
- Promovimi i transportit urban.

2.13.7. Furnizimi me energji elektrike

Komuna dhe qyteti i Fushë-Kosovës furnizohen nga trafo-stacioni 35/10 kv. që ndodhet në qytetin e Fushë-Kosovës. Në trafo-stacion ndodhen katër (4) transformatorë me nga 8 MW dhe pajisjet gjegjëse matëse dhe mbrojtëse. Pajisjet shpërndarëse të trafo-stacionit që të gjitha janë 10 kv. dhe janë të montuara para luftës. Kjo do të paraqet problem, sepse sipas rregullave të IEC-s të cilave jemi të obliguar t'u përshtatemi edhe ne. I tërë sistemi elektro-energjetik 10 kv. duhet të kalojë në 20 kv. në një të ardhme jo shumë të largët. Trafo-stacioni 35/10 kv. i Fushë-Kosovës i ka gjithsej trembëdhjetë (13) dalje.

2.13.8. Sistemi i Telekomunikimit

E tërë Komuna e Fushë-Kosovës lidhet me sinjal telekomunikues përmes postave të Fushë-Kosovës, Sllatinës (Albanës) dhe Bardhit. Të gjitha këto posta lidhen përmes kabullit optik me qendrën në Prishtinë. Përpos kabullit optik, si lidhje rezervë ekziston edhe sistemi i antenave. Nga secila prej këtyre postave shpërndarja e mëtutjeshme bëhet përmes kabllove nëntokësore shumë-fijore. Kabllot nëntokësore kryesisht janë të shpërndara përgjatë pjesëve anësore të rrugëve kryesore ose sekondare. Linjat nëntokësore kur ofrohen afër lagjeve ngrihen në shtylla e nga aty shpërndahen nëpër lagje. Në postën e Bardhit lidhen fshatrat: Bardhi i Madhë, Pomozotini, Graboci dhe Pomozotini. Me postën e Sllatinës (Albanës) lidhen fshatrat si: Sllatina e Vogël, Sllatina e Madhe, Bardhi i Vogël, Henci, Harilaçi. Me postën e Fushë-Kosovës lidhet qyteti i Fushë-Kosovës dhe fshatrat tjera që nuk lidhen me dy postat e përmendura më lartë.

2.14. Shërbimet sociale

Gjendja sociale është në proces të vazhdueshëm të përmirësimit dhe ndryshimit në përgjithësi. Kjo varet nga zhvillimi i shumë faktorëve, të cilët po ashtu janë variabilë. Zhvillimi social varet prej tre (3) sektorëve bazë të zhvillimit social, të cilët ndryshojnë në funksion me ndryshimin e nevojave njerëzore dhe ata janë:

- Shëndetësia - jetë e gjatë dhe e shëndoshë për banorët;
- Arsimi - marrja e aftësive, njohurive profesionale dhe të përgjithshme, dhe;
- Qasja në burimet private dhe publike, të nevojshme për një jetë të mirë.

2.14.1. Shëndetësia


Në Komunën e Fushë-Kosovës për herë të parë pas luftës ka filluar funksionimi i Q.K.M.F (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare), më saktë në tetor të vitit 2000 dhe atë në kushte joad-ekuante, pasi që në objektin ekzistues ka qenë duke funksionuar shëndetësia e pushtetit paralel serb, në të cilën nuk kanë pasur qasje popullsia shqiptare. Pas ngjarjeve të vitit 2004 ky objekt është liruar, mirëpo stafi shëndetësorë ka filluar punën në vitin 2008.

Tani, përveç Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Fushë-Kosovës funksionojnë Qendra të Mjekësisë Familjare në Miradi të Poshtme, Sllatinë të Madhe, Bardh i Madh, si dhe Punktet shëndetësore në Miradi të Epërme, Vragoli, Kuzmin, ku të gjitha këto objekte kanë sistemin e ngrohjes, rrjetin e ujësjellësit, rrjetin e kanalizimit dhe infrastrukturën përcjellëse.

Komuna e Fushë-Kosovës, si rezultat i zhvillimeve dhe kushteve të mira që ofron për qytetarë, gjatë viteve të fundit ka pasur shtim të popullsisë dhe si pasojë e migrimit të brendshëm nga pjesët e ndryshme të Kosovës janë në rritje të vazhdueshme kërkesat e shërbimeve shëndetësore dhe sociale.

Meqenëse shpërndarja e mjekëve është bërë sipas raportit 1:2 (një mjek dhe dy infermiere) në 2000 banorë dhe atë bazuar në regjistrimet e popullsisë së vitit 1981 sipas të cilave në Komunën e Fushë-Kosovës jetojnë 32.000 banorë (në këtë proporcion stafi mjekësorë, stafi social dhe stafi i Drejtorisë së Shëndetësisë numëron 117 punëtorë).

Sipas RZhNj 2004, jetëgjatësia mesatare në Kosovë është 68.8 vjet (për femra 69.9 dhe për meshkuj 67.8 vjet).



Harta 5. Shpërndarja hapësinore e objekteve shëndetësore në Komunën e Fushë-Kosovës



Foto 1. QKMF

Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe punktet shëndetësore, në Komunën e Fushë-Kosovës, ofrojnë këto shërbime shëndetësore (shërbime pediatrie, laboratorike, stomatologjike, gjinekologjike, vaksinimi), kryesisht të shërbimit primar dhe publik. Në lëmin e kujdesit primar bëjnë vizita të rregullta mjekësore, diagnostifikimin e hershëm të sëmundjeve, mjekimi i sëmundjeve, referimi i rasteve urgjente dhe sëmundjeve të tjera të cilat kërkojnë hospitalizim, mjekim kirurgjik dhe rehabilitim.

Në lëmin e shëndetësisë bëjnë imunizimin e fëmijëve, kontrollimin e ujit të pijshëm, vizita sistematike të nxënësve dhe arsimtarëve, edukimin shëndetësor përmes kampanjave në media, lufta kundër dukurive të këqija në shoqëri, sidomos të grup-moshat e reja si: AIDS, Droga, Alkooli, delikuenca etj.

Tabela 7.

Numri i institucioneve shëndetësore dhe personelit në shëndetësinë primare KK Fushë-Kosovë

| | QKMF | Ambulanca Punkte shëndetësore | Ordinanca private mjekësore | Barnatore | Qendra për punë sociale | Të tjera |
|-------------------------------|------|-------------------------------------|-----------------------------------|-----------|----------------------------|----------|
| Numri i institucioneve | 1 | 10 | 25 | 13 | | - |
| Numri i punëtorëve | 107 | - | - | - | 10 | - |

(Burimi: Drejtoria Komunale për Shëndetësi)

REKOMANDIMET:

- Zgjerimi i shërbimeve, hapësirave, shtim i numrit të personelit, modernizimi i aparaturave;
- Trajnime të vazhdueshme të stafit;
- Integrimi në shoqëri i personave me aftësi të kufizuara;
- Përmirësimi i mirëqenies sociale;
- Mbrojta e popullatës nga sëmundjet ngjitëse, vaksinim permanent dhe;
- Dezinfektim, dezinfektim dhe derratizim permanent.

2.15. ARSIMI

Sistemi edukativo-arsimor në Komunën e Fushë-Kosovës është i organizuar dhe funksionon në tri nivele:

- Arsimin parashkollor,
- Arsimin fillor dhe
- Arsimin e mesëm.

Në Fushë-Kosovë funksionojnë dy çerdhe/kopshte për fëmijë. Njëra çerdhe ka kapacitet për 198 fëmijë me qëndrim ditor. Kujdesin dhe edukimin e fëmijëve e realizojnë nëntëmbëdhjetë (19) edukatore



Foto 2. Çerdhe/ kopshti



Foto 3. Shkolla mesme Fushë-Kosovë

Arsimi i mesëm zhvillohet në tri (3) shkolla të mesme. Në Gjimnazin e qytetit, në Shkollën Teknike, dhe në Shkollën Ekonomike, me gjithsej 1795 nxënës, me nr. personeli 72 dhe një arsimtar është për 24 nxënës.



Foto 4. Shkolla fillore - Miradi e Poshtme

Numri i nxënësve i përfshirë në shkollim me tri nivelet në Komunën e Fushë-Kosovës është 7907, personeli edukativo-arsimor është 377 dhe një arsimtar zhvillon këtë proces të rëndësishëm shoqëror dhe kombëtar për 21 nxënës.

Tabela 8. Numri i nxënësve dhe arsimtarëve, sipas nivelit të arsimit (v. 2011)

| | Niveli i arsimit | Nr. i nxënësve | Nr. i personelit arsimorë | Nr. i nxënësve për arsimtarë | Nr. i punëtorëve administrativë | Nr. i punëtorëve teknik-ndihmës |
|---|------------------|----------------|---------------------------|------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|
| 1 | Çerdhja | 198 | 19 | 10.4 | 3 | 4 |
| 2 | Fillor | 5914 | 286 | 20.6 | 14 | 52 |
| 3 | Mesëm | 1795 | 72 | 24 | 3 | 7 |
| | Gjithsej | 7907 | 377 | 20 | 20 | 63 |

2.16. TRASHËGIMIA KULTURORE

Gjetjet arkeologjike në Fushë-Kosovë (Kalanë e Harilaçit dhe të Bardhit) kanë mbështetur përfundimin së ky lokalitet është një nga zonat e vjetra të qytetërimit parahistorik në Ballkan. Vlerat e jashtëzakonshme turistike dhe kulturore tona janë të gërshetuara dhe lidhura ngushtë me ato natyrore. Në të gjithë territorin ekzistojnë vende të rëndësishme kulturore-historike.

Në qytet dhe rrethinat e tij ekzistojnë një rrjet me atraksione kulturore të rëndësishme:

1. Xhamia e qytetit;
2. Xhamitë në të gjitha fshatrat e Komunës;

3. Kisha serbe në qytet dhe në fshatra serbe;
4. Muzeu i qytetit;
5. Kalaja në Harilaç;
6. Kalaja në Bardh të Madh;
7. Shtëpia e kulturës në qytet dhe në disa fshatra;
8. Bibliotekë, arkiva;
9. Objektet kulturore;
10. Monumenti “Imer Sfarqa”;
11. Monumenti “Hashim Hajdini”;
12. Pllaka “Nënë Tereza” dhe;
13. Monumente të tjera.



Foto 5. Elemente nga kalaja në Bardh të Madh

Fushë-Kosova ka premisa pra të mira për t'u zhvilluar, sepse ka atraksione të fuqishme kulturore, ku futen objekte muzeale, arkeologjike, fetare, që kanë vlera jo vetëm për Komunën, por edhe për Kosovën.

Në hartimin e politikave për të gjallëruar turizmin kulturor, duhet të mbahet parasysh fakti që shumë prej turistëve që do të vinin kanë nivel të lartë të arsimit dhe do të jenë gati të shpenzojnë shumë para. Në këto kushte shërbimi dhe niveli turistik duhet të jetë në nivele maksimale.

2.16.1. Kultura, sporti dhe rekreacioni

Numri i ndërtesave kulturore në Komunën e Fushë-Kosovës nuk është i madh dhe shumica janë në gjendje jo të mirë fizike ose të pakompletuara, në mungesë të investimeve. Shpërndarja hapësimore dhe kapacitetet e këtyre ndërtesave nuk janë të mjaftueshme në raport me numrin e banorëve. Ato janë të përqendruara në qytetin e Fushë-Kosovës. Në tërë Komunën ekziston vetëm një shtëpi e kulturës (Qendra e Kulturës).

2.16.2. Qendra Rinore – Fushë-Kosovë

Menaxhimi i këtyre ndërtesave bëhet përmes niveleve të ndryshme shoqërore - Drejtorisë Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport, apo nga vetë komuniteti.

Sa i përket përbajtjeve sportive dhe rekreative, në Komunë dominojnë ato të llojit të hapur. Këto përbajtje janë të përhapura në vendbanimet që shtrihen në pjesët qendrore, lindore dhe jugore të Komunës, derisa pjesët veriore kanë mbulueshmëri të varfër. Për shkak të gjendjes së trashëguar dhe mungesës së investimeve publike, nuk mund të thuhet se të gjitha këto hapësira janë në gjendje të mirë. Shumica e këtyre përbajtjeve menaxhohen nga DKRS, ndërkaq viteve të fundit rrjeti i përbajtjeve sportive është duke u zhvilluar edhe me objekte dhe hapësira të reja të ndërtruara përmes investimeve private.

Në kuadër të rrjetit të përbajtjeve sportive dhe rekreative, si pjesë e veçantë, mund të futen edhe terrenet sportive në disa shkolla të vendbanimeve rurale.

2.16.3. Sportet amatore

Edhe sporti, sikurse shumica e fushave të tjera, doli me shumë probleme pasluftës. Objektet sportive me të cilat disponon Komuna janë të pamjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive të klubeve të ndryshme, të të rinjve dhe qytetarëve. Andaj, shumë klube sportive për zhvillimin e aktiviteteve të tyre sportive shfrytëzojnë sallën e sportit të shkollës së mesme në Fushë-Kosovë.

Në Komunë ekzistojnë klube të ndryshme sportive si: klube futbollit, basketbollit, ping-pong, volejbolli, karate, skijim etj., si vijon:

1. K. F,
2. K. SH
3. K. V (Femrat)
4. K. V (Meshkujt)
5. K. SH
6. K. B
7. Ping-pong
8. Ping-pong
9. K. K
10. K. K
11. Klubi i skijimit

Në Komunën e Fushë-Kosovës ekzistojnë dy (2) salla për sport, 14 fusha sportive dhe stadiumi i futbollit në Fushë-Kosovë.

REKOMANDIMET:

- Mbrojtja e zonave arkeologjike;
- Pasurim i bibliotekave;
- Prezantimi i atraksioneve për turizëm dhe sport, dhe ;
- Rritja e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërkomunal për kulturë, rini, sport etj.


2.17. RESURSET NATYRORE

2.17.1. Resurset minerale

Në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës ka rezerva të mëdha të qymyrit, të tipit linjit, që shfrytëzohen në minierën sipërfaqësore të Bardhit të Madh. Përpos linjtit, si mineral energjetik, i cili është shumë i përhapur në pjesën qendrore të Komunës së Fushë-Kosovës, në pjesën JP më konkretisht në fshatin Harilaç, kemi rezerva të hekur-nikelit, si dhe mineralit të magnezitit. Pjesa VP e territorit të Komunës së Fushë-Kosovës është zonë malore dhe karakterizohet me resurse natyrore për materiale ndërtimore. Në fshatin Harilaç hasim shkëmbinj me fortësi të madhe si: dunite, serpentinite, harzburgite etj., që parashihet të shfrytëzohen në të ardhmen në infrastrukturë. Pastaj, gurë gëlqeror, të cilët ndodhen në fshatin Graboc i Poshtëm dhe në fshatin Bardh i Madh, shkëmbinj që aktualisht përdoren me të madhe në infrastrukturën rrugore. Përveç shkëmbinjve të fortë në pjesën qendrore të Komunës së Fushë-Kosovës hasim edhe shkëmbinj të butë, siç është argjila, nga e cila mund të prodhohen blloka, tulla dhe tjegulla të formave dhe madhësive të ndryshme. Shfrytëzimi i këtyre mineraleve dhe materialeve ndërtimore në masë të madhe e ndotin mjedisin (ajrin, ujin dhe tokën) e Komunës së Fushë-Kosovës dhe krijojnë mbeturina industriale të cilat janë shumë të dëmshme për shëndetin e qytetarëve dhe kërkojnë një trajtim-menaxhim të veçantë.

2.17.2. Toka bujqësore

Në Komunën e Fushë-Kosovës ka një përzierje të sipërfaqeve pyjore, sipërfaqe bujqësore - ara, sipërfaqe kullosa, sipërfaqe kodrinore, si dhe mes tyre zonat e ndërtuara. Komuna e Fushë-Kosovës ka gjithsej 54.35 % tokë bujqësore (rurale) të evidentuar si të tillë (DUKMM, KK Fushë-Kosovë), pyje 13.63 %, djerrinë 1.6 %, tokë të ndërtuar 14.19 %, deponi pasive hiri 10.26 %, industri 5.47 % dhe deponi aktive hiri 0.5 %.



Harta 6. Shfrytëzimi i tokës

Pjesa 3

GJENDJA E MJEDISIT

Gjendja e mjedisit është si rezultat i zhvillimit të pakontrolluar në sektorët industrialë dhe urbanë, planifikimit joadekuat të pajisjeve industriale dhe urbane, teknologjisë së vjetër industriale, teknologjisë joadekuate në disa departamente industriale të resurseve natyrore, infrastrukturës joadekuate në qytete, shtimi i numrit të automjeteve, ndotja e rrjedhave të ujit për shkak të mungesës së trajtimit të ujërave të zeza, akumulimi i plehrave urbane dhe të ngurta industriale, prerja e pakontrolluar e pyjeve, erozioni i dheut dhe aktivitetet e tjera të njeriut. Huluntimet e bëra gjatë dhjetë vjetëve të fundit, edhe pse të pakta, kanë identifikuar burime të ndryshme të ndotjes në Kosovë, që ndikojnë në cilësinë e ajrit, ujit, tokës dhe ekosistemeve. Shumë nga këta ndotës mbesin në mjedis madje edhe pasi që burimet e tyre të jenë eliminuar ose zvogëluar. Që nga fillimi i periudhës tranzitore përpjekjet për zvogëlimin e niveleve të ndotjes kanë qenë të pakta, apo edhe kanë munguar fare. Për më tepër, me rimëkëmbjen graduale të ekonomisë, nivelet e shumë aktivitetëve industriale, bujqësore dhe urbane kanë filluar të rriten. Sektorët e energjisë dhe të transportit paraqiten si burimet më të mëdha të ndotjes në Fushë-Kosovë. Këtu bëjnë pjesë prodhimi i energjisë elektrike, kryesisht nëpërmjet djegies së thëngjillit në termocentrale të mëdha, (Termocentralet Kosova A dhe B), si dhe gazrat të cilat lirohen nga automjetet e vjetruara. Përveç që kanë shkaktuar ndotje të ajrit, këto degë të industrisë kanë krijuar edhe deponi të mëdha të mbeturinave të ngurta. Edhe industritë tjera të lehta kanë shkaktuar probleme mjedisore.

Mjedisi ndotet edhe nga hedhurinat shtëpiake dhe të biznesit të vogël, sidomos në periudhën pas konfliktit. Shikuar në përgjithësi, as popullata nuk është nxitur të përkujdeset për mjedisin. Kështu, hedhja e mbeturinave dhe derdhja e ujërave të zeza në lumenj bëhet pa ndonjë trajtim paraprak. Përdorimi i pesticideve, ujërat e kulluara nga aktivitetet bujqësore, numri i rritur i automjeteve personale dhe komerciale, sidomos në hapësirat më të mëdha urbane, dhe sistemi i ngrohjes së shtëpive private me dru ose thëngjill gjatë dimrit, po ashtu llogariten si ndotës të mjedisit.

Pluhuri mund të depërtojë nëpërmjet të reshurave në ujëra nëntokësore dhe në këtë mënyrë të shkaktojë ndotjen e resurseve ujore që janë në përdorim të popullatës. Komuna e Fushë-Kosovës është njëra ndër Komunat me ambient më të ndotur në tërë territorin e Kosovës. Ekzistojnë faktorë të shumtë që ndikojnë në ndotjen e ambientit. Si p.sh.: uzurpimet dhe përvetësimet e pronës shtetërore dhe private, duke ndërtuar objekte pa leje ndërtimi, nëpër toka bujqësore, sipërfaqe gjelbëruese dhe sipërfaqe të destinuara për infrastrukturë, pastaj duke dëmtuar monumente dhe lokalitete me vlera kulturore, historike dhe arkitektonike. Ndërtimi i objekteve të tilla është i rrezikshëm, si për ambientin (vendbanimet), ashtu edhe për njerëzit. Të tilla janë pompat e benzinës, depot e ndryshme, objektet ekonomik-industriale që kanë teknologji të vjetruar dhe të dëmtuar, mbeturinat e natyrave të ndryshme etj.

3.1. Menaxhimi i ajrit

Ndotja e ajrit në Fushë-Kosovë shkaktohet kryesisht nga termocentralet, si dhe transportit rru- gor dhe hekurudhor. Ndotësit specifik që emitohen nga këto industri janë: dyoksidi i sulfurit, oksidi i nitrogenit dhe grimcat e pluhurit. Është dëshmuar se këta ndotës, brenda një periudhe më të gjatë, shtojnë rrezikun nga sëmundjet respiratorë dhe sëmundjet e tjera të ngjashme për popullatën në përgjithësi. Sasia e gjithmbarshme e dyoksidit të sulfurit të emituar nga të gjitha kategoritë e burimeve të ndotjes së ajrit në Kosovë ishte 104.240 tonë, brenda një viti.

Siç është cekur më lart, një ndër burimet më të mëdha të ndotjes në Kosovë është sektori en- ergjetik –Termoelektranat e Kosovës, të cilat gjenden dy kilometra larg Fushë-Kosovës. Sektori i en- ergjetikës për prodhimtarinë e saj shfrytëzon zonat të cilat janë të pasura me thëngjill/linjit. Burimet e shpenzimeve të termocentraleve me thëngjill janë dy (2) miniera të thëngjillit skaj/afër termo- centralit. Të dy termocentralet vuajnë nga mungesa e mirëmbajtjes. “Kosova B”, e cila është e diza- jnuar nga Kompanitë Evropiane, ka të montuar filtrat të cilët kanë një kapacitet të filtrimit të tymit prej 98 %. Filtrat e instaluar në “Kosovën A”, të dizajnuar nga ish-BRSS, operojnë me një kapacitet të reduktuar me një shkallë të eliminimit në mes 50-80 %. 200MW njësi emitojnë rreth 25 tonë pluhur për një orë, e cila rezulton me një lartësi të ndotjes për 74 herë më shumë se që lejojnë stan- dardet evropiane. Në vitin 2002 shuma e përgjithshme e shfrytëzimit të thëngjillit është paraqitur më poshtë, së bashku me vlerën e lirimimit të CO₂.

Emisioni tejet i lartë i pluhurit nga Termocentralet e Kosovës shkaktohet në rend të parë nga efik- asiteti i ulët i elektroprecipitatorëve, mirëpo edhe nga sasia e madhe e pluhurit të mbetur pas dje- gjes së linjtit. Në përbërjen e emisionit të dalë nga termoelektranat janë elementet si CO₂, SO₂, NO_x dhe pluhur, por aktualisht në nivelin e emisionit nuk është bërë ndonjë matje. Emisioni i pluhurit mund të kalojë nivelin e lejuar për shkak të funksionimit të dobët të filtrave në “Kosovën A”. Të gjitha këto emisione çojnë deri te rreziku nga sëmundjet e trakteve respiratorike të larta dhe të ulëta, përfshirë këtu edhe infeksionet dhe alergjitë. Ndotësit kryesorë nga termoelektranat janë CO₂, SO₂, NO_x, O₃, grimcat e ajrit, si dhe sedimentet.


Tabela 9. Mihja e thëngjillit në vitin 2002 dhe lirimi i CO₂ (vlerësimet)

| | Thëngjilli i pjekur në tona | Lirimi i CO ₂ në ton (vlerësimi) |
|-------------------------|-----------------------------|---|
| Termo centralet , etj . | 5.542.269 | 4.467.069 |
| Shfrytëzuesit privat | 47.724 | 38.466 |
| TOTALI 5.589.993 | | 4.505.535 |


Tabela 10. Vlera mesatare e ajrit, lokacioni matës: “INKOS” - zona industriale e KEK-ut

| Ndotë- sit | Njësia | Jan. | Shkur | Mars. | Prill. | Maj. | Qersho | Korrik | Gusht | Shtat. | Teto. | Nënt. | Dhjet. |
|-------------------|------------------------|-------|-------|-------|--------|------|--------|--------|-------|--------|-------|-------|--------|
| SO ₂ | µg/m ³ | 22,43 | 19,0 | 18,04 | 17 | 16,7 | 13,32 | 25,9 | 13,14 | 23 | 12 | 19 | 20 |
| Biozë | µg/m ³ | | 11,43 | 7,23 | 10,11 | 10,5 | 10,13 | 7,27 | 12,25 | 8,3 | 15 | 19,1 | 29,12 |
| Grimc at nga ajri | µg/m ³ | | | | | | 90 | 113,5 | 72,6 | 98,28 | 124,6 | 79,3 | 122,3 |
| Sedi mentet | mg/ (m ² d) | 1137 | 1140 | 1722 | 3039 | 312 | 655 | 559 | 1096 | 1161 | 534,6 | 811 | 1457 |

Diagrami 4. Sediment



Diagrami 5. Grimcat e ajrit



REKOMANDIMET::

- Inspektimi dhe kontrollimi i industrisë dhe ndërtimitarisë për aplikimet ose jo të standard-eve të mbrojtjes së ajrit;
- Vendorsja e aparaturave për monitorim të cilësisë së ajrit në disa zona;
- Cilësia e karburanteve;
- Pyllëzimi dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse gjelbëruese përreth depove të KEK-ut;
- Mbjellja e bimëve mbrojtëse halore përreth gjithë ngastrave të objekteve industriale publike dhe private, dhe;
- Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese për kokë banori.

3.2. Menaxhimi i ujit

Viteve të fundit është bërë investim në rregullimin e rrjetit të ujësjellësit të qytetit dhe lokaliteteve të tjera. Sasia e ujit të prodhuar, brenda 24 orëve, është 7415 m³. Megjithatë, ndihet prapë nevojë permanente për riparim të gypave të vjetër në qytet, si dhe shtimi i kapaciteteve prodhuese, ngritja e sasisë dhe cilësisë së ujit të pijshëm.

3.2.1. Resurset ujore

Territori i Komunës së Fushë-Kosovës është mjaft i pasur me ujëra, si sipërfaqësorë ashtu edhe nëntokësorë. Lumenjtë të cilët kalojnë nëpër territorin e Komunës së Fushë-Kosovës janë: “Sitnica”, “Drenica”, “Prishtevka” dhe “Graçanka”. Pranë këtyre lumenjve rrjedhin edhe një numër i vogël i përroskave, të cilat nuk kanë rrjedhje të përhershme, por vetëm atëherë kur ka të reshura atmosferike. Po ashtu ekziston edhe Liqeni Akumulativ në fshatin Henc.

Përpos ujërave sipërfaqësorë, Komuna e Fushë-Kosovës është mjaft e pasur edhe me ujëra nëntokësorë. Këto ujëra nëntokësore (akuifere) kanë një shtrirje bukur të gjerë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës. Përdoren për pije dhe menaxhohen nga KUR (Kompania e Ujësjellësit Rajonal) “Prishtina”. Prej këtyre puseve me ujë të pijes furnizohet Komuna e Fushë-Kosovës në tërësi dhe më gjerë. Uji nëntokësor shtrihet ndërmjet fshatrave Henc-Vragoli-Kuzmin dhe një pjesë të qytetit të Fushë-Kosovës. Në fshatin Kuzmin ekzistojnë dymbëdhjetë (12) puse nga 22m. Thellësi, si dhe fabrika për përpunimin e ujit që menaxhohet nga “Ujësjellësi Rajonal Batllava”. Në Vragoli janë pesë (5) puse, Miradi e Poshtme një (1) pus dhe fabrika për përpunimin e ujit, si dhe në Henc një (1) pus. Komuna e Fushë-Kosovës, për përmirësimin e jetës së qytetarëve me ujë të pijshëm, në vitin 2011 ka bërë hapjen e tetëmbëdhjetë (18) puseve të tjera në lokacione të ndryshme në qytet

dhe fshatra, si dhe rezervuarin për ramje të lirë të ujit në fshatin Bardh i Madh. Ekzistojnë edhe disa burime, si në: Sllatinë të Madhe (Kroi i Malit); Harilaç (Kroi i Spahisë) etj. Këto ujëra për fat të keq ndoten shumë nga rrjeti i kanalizimeve, vajrave industriale, mbeturinave të të gjitha llojeve etj.

REKOMANDIMET::

- Përmirësim i gypave të vjetër të azbestit, me gypa të rinj;
- Evitimi i humbjeve të ujit;
- Shtimi i kapaciteteve prodhuese të ujit për pije;
- Monitorim i vazhdueshëm cilësor dhe sasior i ujit për pije;
- Rritja e ekonomive familjare të cilët kanë qasje në rrjetin publik të ujësjellësit dhe;
- Ndërgjegjësim dhe vetëdijësim i popullatës për kursim të ujit për pije.

3.2.2. Ndotja e resurseve ujore

Në Fushë-Kosovë ndotja shkaktohet kryesisht nga hedhurinat e pa trajtuara të industrisë së lehtë dhe nga derdhja e ujërave të zeza. Viteve të fundit, ndotja e rrjedhave ujore ka filluar të shkaktohet edhe nga aktivitetet e tjera, si komerciale, ashtu edhe të rekreacionit. Ndotësit që hedhen në ujë janë të karakterit inorganik dhe organik. Në substancat organike bëjnë pjesë komponimet shumë të rrezikshme të fenolit. Në përgjithësi, është konstatuar se këta ndotës shtojnë rrezikun për probleme të ndryshme shëndetësore, duke përfshirë sëmundje të ndryshme dhe çrregullime në zhvillim. Rrjedhat ujore në Fushë-Kosovë nuk janë aq të mjaftueshme për të mos qenë të pacenueshme ndaj nivelit të tanishëm të ndotjes. Pjesa më e madhe e këtyre ujërave të ndotur derdhet në lumin “Sitnicë” (91 %), çka e bën sistemin e lumenjve “Sitnicë”-“Ibër” një kolektor të hapur të ujërave efluente industriale. Në këtë sistem lumenjsh derdheshin, përveç tjerash, ujërat e “Termocentraleve të Kosovës”, të prodhimit të Ferro-nikelit. Rrjedhimisht, ky sistem i lumenjve ndotet me sasi të mëdha të komponimeve inorganike dhe organike. Lumenjtë që kalojnë në territorin e Fushë-Kosovës (“Prishtevka”, “Sitnica”, “Drenica”) janë shumë të ndotur, e po ashtu, të ndotura i kemi edhe fshatrat përreth, si pasojë e hedhjes së pakontrolluar të mbeturinave, mungesës së kolektorëve, mungesës së impiantit për trajtim të ujërave të ndotur, mungesës së ujit, si dhe edukatës së shëndoshë civilizuese.

Në territorin e Fushë-Kosovës, në burimet e ndotjes së ujit, numërohen “Termoelektrana e Kosovës”, pasi që siç dihet nga tymbtarët e shumtë lirohen sasi të mëdha të gazrave të cilët së bashku me pluhurin e madh që shkakton hiri i grumbulluar rreth termoelektraneve dhe nga fenolet dhe materiet e tjera që derdhen nga Termoelektrana (nga larja e thëngjillit) bëhet ndotja e ujit në lumin “Sitnicë”. Në tërë këtë zonë, pothuaj në një sipërfaqe prej 10km², uji nuk preferohet të pihet për shkak të ndotjes së madhe që mund të ketë duke marrë parasysh edhe ndotjen gjatë rrjedhjes së tyre nëpër vendbanime, ku në mënyrë të pakontrolluar bëhet hedhja e ujërave të zeza dhe shumë mbeturinave të tjera. Monitoringu intensiv i cilësisë së ujit të lumenjve të Fushë-Kosovës, i bërë, tregon se ndotja e lumenjve me materie organike është e madhe, sidomos në lumenjtë dhe përroskat urbane. Sasi të mëdha të materieve organike nga këto rrjedha barten në lumenjtë e Kosovës.


Kështu, bartja e këtyre materieve nga lumi “Prishtevkë” në lumin “Sitnicë” e rritë nivelin e ndotjes së këtij lumi me materie organike për 7-12 herë.

Tabela 9. Vlera mesatare e analizave fiziko-kimike të ujërave të Fushë-Kosovës, për vitin 2010


| Lumenjtë | Pika monitoruese | Vlera TDS-mg/l-2007 | Vlera PH | Vlera e O ₂ të tretur-mg/l |
|------------|------------------|---------------------|----------|---------------------------------------|
| Sitnica | Vragoli | 325 | 7.78 | 4.94 |
| Prishtevka | Bresje | 362 | 7.81 | 4.28 |
| Graçanka | Miradi | 760 | 7.74 | 9.42 |
| Drenica | Vragoli | 382 | 7.94 | 7.31 |

3.2.3. Monitorimi i cilësisë dhe sasisë së ujërave


Ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë nuk janë të mbrojtur aq mirë nga ndotja dhe nuk respektohen zonat sanitare. Monitorimi i ujërave realizohet nga niveli qendror nga KUR-Prishtina dhe IKSHP-së.



Harta 7. Kualiteti i ujit



Harta 8. Harta e ujërave të ndotura



Harta 9. Harta e mbrojtjes së ujërave nga ndotja

2.2.4. Menaxhimi urban i kanalizimit

Sistemi i kanalizimit kryesisht është i ri, i punuar pasluftë, në fshatra dhe në disa pjesë të qytetit, mirëpo një pjesë është i vjetër. Qasje në kanalizim kanë 90 % të qytetarëve, ose kemi 47.000 m. gjatësi. Kanalizimi i ndërtuar në vitet e fundit i plotëson standardet e parapara ndërtimore. Mirëpo, shqetësim kryesor në këtë fushë është mungesa e investimeve për ndërtimin e kolektorëve dhe impiantit për trajtim të ujërave të zeza, si rezultat i mungesës së mjeteve financiare.

REKOMANDIMET:

- Përmirësimi i infrastrukturës së kanalizimit;
- Në sistem të kanalizimit të përfshihen 95 % e qytetarëve;
- Ndërtimi i kolektorëve në pika ku derdhet kanalizimi nëpër lumenj;
- Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza, të bardha edhe industrialë;
- Pastrimi i përroskave dhe lumenjve nga mbeturinat;
- Zgjidhja e problemit të ujërave të zeza të Aeroportit dhe;
- Vendosja e masave mbrojtëse të ujit (impianteve) tek të gjithë ndotësit potencialë në Komunë, si në fabrika, qumështore, ferma etj.

3.3. Menaxhimi i mbeturinave

Gjenerimi i mbeturinave paraqet një ndër shqetësimet më të mëdha për mjedisin në Komunën e Fushë-Kosovës. Për këtë arsye Komuna si prioritet kryesor të vitit 2011-2016 e ka mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi dhe në veçanti menaxhimin e mbeturinave.

Projekti për eliminim në tërësi të depove të egra do të vazhdojë edhe në vitet që do të vijnë, ku janë ndarë edhe mjete financiare për këtë projekt.

Tabela 10. Sasia e mbeturinave që krijohen në Komunën e Fushë-Kosovës, për kokë banori, është rreth 1.8 kg/d.

| Llojet e mbeturinave | Mesatarja ditore kg/banorë |
|--|-------------------------------|
| Mbaturinat e amvisërisë | 0.255 |
| Mbaturinat komerciale | 0.240 |
| Mbaturinat medicinale | 0.0022 |
| Mbaturinat e ngjyrës dhe hirit | 0.805 |
| Mbaturinat e ndërtimit/shkatërrimit | 0.200 |
| Mbaturina të tjera | 0.350 |
| Total | 1.8 |

Menaxhimi dhe grumbullimi i mbeturinave deri tani është bërë në mënyrë të kënaqshme, megjithëse ndihet nevoja që të rritet cilësia e këtyre shërbimeve dhe zgjerimi i tyre në tërë territorin e Komunës, që përkon edhe me synimet e politikës së ruajtjes së ambientit.

Gjenerimi i mbeturinave paraqet një ndër shqetësimet më të mëdha për mjedisin në Komunën e Fushë-Kosovës. Për këtë arsye, Komuna si prioritet kryesor ka mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi dhe në veçanti menaxhimin e mbeturinave. Projekti për eliminim në tërësi të depove të egra do të vazhdojë edhe në vitet që do të vijnë, ku janë ndarë edhe mjete financiare për këtë projekt. Përveç kësaj, vlen të përmendet se në të gjitha lokalitetet e Fushë-Kosovës janë blerë dhe shpërndarë kontejnerë, si dhe është punuar skica e vendeve për vendosjen e kontejnerëve, i cili veprim qon në rrugë të mbarë për të formuar një sistem të qëndrueshëm për grumbullim të mbeturinave dhe për menaxhim më efikas. Po ashtu, është marrë edhe Urdhëresa Administrative, për të rregulluar këtë çështje, nga ana e strukturave komunale.

Ne synojmë që gjatë vitit 2012 të gjitha ekonomitë dhe amvisëritë familjare t'i vendosim në sistem të pagesave për mbeturina.

3.3.1 Mbeturina të tjera

Territori i Komunës së Fushë-Kosovës është shumë i ndotur nga minierat sipërfaqësore të qymyrit dhe Termocentralet e KEK-ut.

Ndotja e ajrit kryesisht paraqitet në formë të emisioneve të dioksidit të squfurit (SO₂), oksidit të azotit (NO), ozon (O₃), plumb (Pb), dioksid karboni (CO₂), pluhur, grimca të patretshme dhe dioksinë. Si mbeturina të rrezikshme janë edhe depoja e hirit dhe numri i madh i hektarëve me djerina, si dhe depot e egra.

Pastaj, shkarkimi i fekaleve dhe vajrave të ndryshëm nga KEK-u, si dhe shkarkimi i ujërave të zeza urbanistike në lumin “Drenicë” dhe “Sitnicë”.

REKOMANDIMET:

- Krijimi i infrastrukturës ligjore dhe teknike për menaxhim të mbeturinave;
- Zvogëlimi gradual i sasisë së mbeturinave në burim dhe shfrytëzimi energjetik apo ripërdorimit;
- Eliminimi i depove të egra;
- Zvogëlimi gradual i rrezikut nga mbeturinat;
- Riciklimi i mbeturinave;
- Kompostim i mbeturinave;
- Rritja graduale e përfshirjes së popullatës në sistemin e grumbullimit të mbeturinave;
- Krijimi i një Kompanie Komunale për Menaxhim dhe grumbullim të mbeturinave në një periudhë afatmesme dhe;
- Ekodepoja.

3.4. ZHVILLIMI URBAN DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS

3.4.1. Zhvillimi Urban

Me iniciativën e Drejtorisë së Urbanizmit, duke u bazuar edhe në kërkesat e qytetarëve, është hartuar Plani Rregullues Urban. Ky plan u aprovua nga Kuvendi i Komunës, në vitin 2005. Gjatë vitit 2011 ka filluar revidimi i këtij plani. Gjithashtu, pritet që gjatë vitit 2012 të miratohet edhe Plani Zhvillimor Komunal (2012). Nevojitet hartimi i tërësishëm i planeve të reja për qytetin: “Planet rregulluese detale”, për tërë qytetin dhe Komunën në tërësi. Në hartimin e planeve të reja rregulluese duhet gjithnjë të merret parasysh rritja e etazhitetit në lartësi, me qëllim të sigurimit të sipërfaqeve të lira për lojë të fëmijëve, pushim dhe rekreacion, në kufijtë e planit ekzistues të qytetit, meqenëse çdo ditë e më tepër është në rritje numri i banorëve dhe paraqiten kërkesa të reja për hapësira të reja për banim dhe punë. Në disa vende, ku ka mundësi, duhet të rregullohen hapësira për pushim, rekreacion dhe staza për biçiklista. Të hartohen plane rregulluese edhe për viset rurale që të mbrohet toka bujqësore nga degradimet. Për hartimin e planeve të reja paraqiten shumë pengesa, si: mos posedimi i gjendjes faktike për planifikim, gjegjësisht shtrirja fizike e qytetit dhe fshatrave dhe mungesa e informacioneve të domosdoshme për nevojat e planifikimit.

3.4.2. Vendbanimet joformale

Në Komunën e Fushë-Kosovës janë evidentuar dy (2) vendbanime joformale, njëri në Graboc dhe tjetri në Rrafshnaltë. Këto vendbanime mund të trajtohen sipas udhëzimeve të Strategjisë Komëtare dhe Planit të Veprimit për Vendbanime Joformale.

3.4.3. Ndriçimi publik në Komunë

Në Komunën e Fushë-Kosovës janë 42 km. rrugë të qytetit dhe të fshatrave, në të cilat ekziston rrjeti i ndriçimit publik, i cili menaxhohet nga Komuna.

Në vitin 2011 është rregulluar ndriçimi publik-solar, ku në qytet dhe në fshatra janë vendosur 125 shtylla, e ky projekt do të vazhdojë deri sa të kompletohen të gjitha rrugët.

Pozita e favorshme e Fushë-Kosovës në Rrafshin e Kosovës, me të gjitha arteriet kryesore që kalojnë nëpërmes Komunës, i ka siguruar furnizim relativisht të qëndrueshëm me energji elektrike. Problemi kryesor për Komunën është gjendja jo e mirë e sistemit të shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike në fshatra. Shumica e familjeve furnizohen nga linjat e vjetruara dhe disa prej tyre janë në gjendje jo të mirë, apo shumë të vjetërsuar dhe paraqesin rrezik për popullatën.

3.4.4. Industria

Në Komunën e Fushë-Kosovës kryesisht operojnë disa fabrika me kapacitet të ulët prodhues. Në këto ndërmarrje aktiviteti prodhues dhe industrial është ndotës dhe duhet të kenë vlerësim të ndikimit në mjedis për operim, pasi që konsiderohen si ndotës të ambientit në lokacionin ku veprojnë. Në këto ndërmarrje kryhen këto veprimtari: prodhimi i asfaltit, materialit hidroizolues, substancat kimike, prodhime të qumështit etj. Në Komunën e Fushë-Kosovës është një (1) bazë për prodhimin e asfaltit, i cili ndikon dukshëm negativisht në kualitetin e ajrit dhe në mjedis.

Bizneset prodhuese të cilat ndikojnë në mjedis, sidomos në ndotjen e lumenjve, tokës dhe ajrit, janë: “Fabrika e prodhimit të ngjyrave”, “Fabrikat për prodhimin e produkteve të qumështit”, të cilat gjenden në fshatin Miradi e Epërme, “Depot e Derivateve të Naftës dhe Gazrave”, po ashtu në Miradi të Epërme, pastaj ndotja dhe zhurma nga makineritë e rënda të KEK-ut në fshatin Bardh i Madh dhe Graboc, dhe të gjitha bizneset të cilat shtrihen apo janë përgjatë rrugës Pejë-Prishtinë, ku ujërat e zeza dhe industriale i derdhen në degën e lumit “Prishtevkë”, “Graçankë”, “Drenicë”, si dhe në lumin “Sitnicë”. Përveç këtyre, janë edhe një numër prej 30 bizneseve automekanike të regjistruara, të cilat bëjnë ndotjen e mjedisit, ujit dhe ajrit, duke liruar vajrat lubrifikues, pa kriter. Dihet se një (1) litër vaj motorik ndot mbi 1 milion litra ujë. Po ashtu, janë edhe 15 autolarje, të cilat ndikojnë në ndotjen e mjedisit dhe harxhimin e ujit të pijes për autolarje.

REKOMANDIMET::

- Të shtohen hapësirat e gjelbëruara - parqet dhe parkingjet publike;
- Ndriçimi solar i të gjitha lokaliteteve banuese;
- Instalimi i energjisë eficiente në objekte publike dhe;
- Objekte e reja banesore (të larta e të ulëta), si dhe objektet industriale të kenë hapësira të mjaftueshme gjelbëruese, si dhe bimë dekorative.

3.5. Bujqësia

Bujqësia në Komunën e Fushë-Kosovës është dega e dytë ekonomike perka rëndësia dhe se prodhimi i ushqimit ka rëndësi strategjike për shoqërinë dhe zhvillimin e bujqësisë. Në, me Strategjinë Komunale Rurale, i kemi dhënë rëndësi prioritare. Prodhimi i ushqimit të mjaftueshëm dhe cilësorë për mbarë njerëzimin paraqet një rëndësi prej detyrave më humanitare e shumë të rëndësishme për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme. Lirisht mund të thuhet se shëndeti, në radhë të parë, varet prej bujqësisë dhe mënyrës së ushqimit, e mandej edhe prej mjedisit dhe mjekësisë.

Bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik dhe sektor që siguron dhe ofron më së shumti të hyra në periudhën e pasluftës, sepse 1/2 e popullsisë në Komunë jeton në zonat rurale. Kryesisht, të ardhurat e tyre i krijojnë nga aktivitetet bujqësore, por indikator mjaft i rëndësishëm i zhvillimit të aktiviteteve bujqësore është zhvillimi i industrisë ushqimore, e bazuar në produktet bujqësore. Prodhimet e fermerëve nga sektori privat i plotësojnë vetëm nevojat për konsum familjar, rrjedhimisht, nuk mbetet asgjë për treg. Komuna e Fushë-Kosovës posedon 4511 ha tokë bujqësore dhe 1619 ha pyje pra, gjithsej 6130 ha.

3.5.1. Lavërtaria

Drithërat janë kultura bazë për ushqimin e popullatës, të blegtorisë dhe përpunimit industrial. Prodhimi i tyre ka karakter strategjik, aq më tepër kur këtë e lejojnë dhe e favorizojnë burimet natyrore. Problemi konsiston në atë se si të gjenden rrugët dhe mundësitë që këto të shfrytëzohen në mënyrë natyrore dhe me efikasitet. Në periudhën e ardhshme në Komunën e Fushë-Kosovës duhet të ngrihet një sistem i ri i prodhimit bujqësor i reformuar me tipare perëndimore në kushtet e shoqërisë së privatizuar e të modernizuar. Duhet të kultivohen kultivarë me potencial gjenetik më të lartë dhe aplikim të teknologjisë më bashkëkohore, në mënyrë që të rritet prodhimtaria për njësi të sipërfaqes. Nga sipërfaqet me kultura bujqësore, pjesëmarrje më të madhe ka kultura e grurit dhe e misrit.

Struktura e kulturave është:

| | |
|--------------------------------|------------|
| • Grurë | - 2500 ha. |
| • Misër | - 600 ha. |
| • Tërshërë | - 100 ha. |
| • Elb | - 30 ha. |
| • Patate | - 40 ha. |
| • Perime | - 372 ha. |
| • Pemë | - 87 ha. |
| • Bimë foragjere | - 180 ha. |
| • Livadhe | - 438 ha. |
| • Kullosa | - 850 ha. |
| • Të tjera | - 500 ha. |
| • Djerrina (të pashfrytëzuara) | - 1100 ha. |

3.5.2. Perimtaria

Perimtaria është degë e rëndësishme e bujqësisë në Komunën tonë. Është njëra nga degët më të vjetra dhe më të rëndësishme të bujqësisë. Në vitet e fundit tek ne vërehet një orientim mjaft i madh i prodhuesve për prodhimtarinë e perimeve në sera, me ç'rast ata orientohen kryesisht në forma më

të lira të objekteve. Prodhimtaria e perimeve në ambiente të mbrojtura paraqet formën më intensive të prodhimit të tyre.

Intensifikimi i mëtejshëm i prodhimit të perimeve, në të gjitha llojet e ambienteve të mbrojtura tek ne, do ta eliminonte karakterin sezonal të prodhimit të perimeve dhe do të mundësonte furnizimin e vazhdueshëm të tregut me perime të freskëta gjatë tërë vitit, me çmime të arritshme për çdo konsumatorë.

Agrobiznesi tash zhvillohet pothuajse në tërësi në sektorin privat. Për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike në Kosovë, për shkak të pamundësisë së shfrytëzimit të kredive të volitshme, mekanizimi bujqësor në Komunën e Fushë-Kosovës është mjaft i amortizuar. Për Komunë mund të jepet kjo pasqyrë e përafërt e mekanizimit bujqësor:

- Autokombajna - 25 copë;
- Traktorë të tipave të ndryshëm - 550 copë;
- Makina mbjellëse të grurit - 60 copë;
- Makina mbjellëse të misrit - 50 copë;
- Trina - 400 copë;
- Pjatore - 200 copë dhe;
- Plugje - 500 copë.

3.5.3. Blegtoria

Blegtoria është një sektor mjaft i rëndësishëm bujqësor, i cili në vazhdimësi ka dhënë rezultate të mira. Një pjesë e madhe e popullsisë në Komunën e Fushë-Kosovës merret me blegtori dhe realizon të ardhura nga prodhimtaria blegtorale, për këtë arsye është e domosdoshme që kjo degë e blegtorisë të zhvillohet dhe përparohet për t'u arritur një prodhimtari më e madhe e qumështit, dhe prodhimeve të qumështit. Sipas të dhënave në Komunën tonë ekziston një fond prej:

- Gjedhe - 4500 krerë;
- Dele - 900 krerë;
- Dhi - 200 krerë;
- Pula - 28.000 copë;
- Pulat në fermat e organizuara - 3000 copë dhe;
- Zgjoje të bletëve - 1000 koshere.

3.5.4. Bletaria

Në Komunën e Fushë-Kosovës llogariten që të jenë mbi 1000 zgjoje të bletëve. Bletaria ka mundësi të zhvillohet dhe promovohet edhe më tutje, duke marrë parasysh kushtet e volitshme në pjesët rurale. Përfitimi ekonomik është mjaft i lartë nga bletaria, nga prodhimi i mjaltit dhe nën-produkteve të tij.

REKOMANDIMET:

- Inventarizimi i tokave të zhveshura, hartimi i planeve komunale për rivitalizimin dhe pyllëzim të tyre;
- Zvogëlimi gradual i shndërrimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
- Mbështetja institucionale dhe financiare e sektorëve të bujqësisë;

- Promovim i bujqësisë së shëndoshë dhe produkteve ekologjike;
- Ndërtimi i sistemit për ujitjen e tokave bujqësore;
- Shtimi i fondit të lopëve, deleve, dhenve, pulave dhe mjeteve motorike, dhe ;
- Kontrolli i cilësisë së plehrave artificiale dhe pesticideve.

3.6. Veterinaria

Në lëmin e veterinarisë janë disa faktorë që ndikojnë në ndotjen e ambientit p.sh. kemi të bëjmë me qentë endacak dhe ngordhësitat e tyre që sjellin problem të ndotjes së ambientit, por paraqesin edhe një rrezik permanent për popullatën. Rreziku qëndron tek sëmundjet zoonoze, të cilat transmetohen nga kafshët tek njerëzit dhe anasjelltas p.sh. kemi të bëjmë me një sëmundje zonotike që është më problematike sikurse është tërbimi. Origjina e kësaj sëmundjeje vjen nga dhelprat, lakuriqët e natës, të cilët kanë një imunitet ndaj këtij virusi. Mirëpo, qentë endacak janë ata që e transmetojnë më së shumti këtë sëmundje. Si masë preventive për çdo vit duhet të bëhet vaksinimi i tyre, mirëpo problemi qëndron tek qentë endacak pa pronarë, sepse këta qenë nuk mund të kapen për t'u vaksinuar. Pra, rreziku permanent qëndron të ngordhësitat e këtyre kafshëve, të cilat janë shumë të rrezikshme në transmetimin e kësaj sëmundjeje dhe në ndotjen e ambientit. Problem janë edhe ngordhësitat e kafshëve tjera me pronarë, të cilat ngordhin nga sëmundje të ndryshme virale, bakteriale ose ngordhje e natyrshme. Pronarët e papërgjegjshëm këta qenë të ngordhur i hedhin në vende joadekuate dhe këto na paraqesin një rrezik shumë të madh, si për shëndetin e njeriut, transmetimin e sëmundjeve dhe ndotjen e ambientit.

Komuna e Fushë-Kosovës duhet të ketë varreza të kafshëve, marrëveshje e tillë mund të bëhet me kompaninë “Pastrimi”.

Mënyra e eliminimit të qenve endacakë, siç është duke u praktikuar tek ne me armë zjarri, është johumane dhe shumë e trishtueshme, edhe për qytetarët, dhe kjo ndikon në ndotjen e ambientit. Kjo mënyrë është edhe e ndaluar me ligjin në fuqi të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, Ligji për Veterinarinë 2004\21. Në Komunën e Fushë-Kosovës operojnë mbi 10 barnatore që ofrojnë inpute dhe shërbime bujqësore profesionale.

REKOMANDIMET:

- Caktimi i një depoje për groposjen e kafshëve të ngordhura;
- Caktimi i një hapësire për mbajtjen e qenve endacakë dhe;
- Eliminimi i qenve endacakë me eutanazi dhe sipas metodave më humane të përcaktuara me ligj.

3.7. Biodiversiteti dhe trashëgimia natyrore

Ndryshueshmëria midis organizmave të gjallë që jetojnë në ekosistemet tokësore, detare dhe ekosisteme të tjera ujore dhe komplekset ekologjike në të cilat ato bëjnë pjesë, kjo përfshin diversitetin brenda llojit, midis llojeve dhe ekosistemeve.

E thënë me fjalë të tjera, termi diversitet biologjik shpreh numrin dhe gjithë larminë e organizmave të gjallë në planet. Brenda këtij termi përfshihet diversiteti i gjeneve, llojeve dhe ekosistemeve që janë produkt i një procesi evolutiv përmes tre (3) miliardë vjetëve. Njerëzimi dhe mbijetesa e tij varet nga ky diversitet biologjik. Në këtë kuptim termi diversitet biologjik është sinonim i termit “Jeta në planet”.

Pozita e volitshme gjeografike, veçoritë klimatike, relieve, faktorët hidrologjik e gjeologjik, si dhe ndryshimet e shpeshta të kushteve klimatike, kanë ndikuar në zhvillimin dhe ruajtjen e habitateve

dhe ekosistemeve natyrore që ofrojnë kushte për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore.

Shumë prej tyre janë relikte endemike dhe subendemike.

Vargmalet e Sharrit, si pikë e biodiversitetit, e njohur jo vetëm në Kosovë, por edhe në Gadishullin Ballkanik dhe Evropë. Deri më tani janë evidentuar më shumë se 2000 lloje bimore, shifër kjo që paraqet 25 % të florës së Ballkanit dhe 18 % florës së Evropës.

Në bazë të të dhënave ekzistuese rreth 29 % e këtyre llojeve janë endemike, ndërsa rreth 10 % janë subendemike. Prej numrit të përgjithshëm të këtyre llojeve, të evidentuara në malet e Sharrit, 86 lloje janë shpallur me rëndësi ndërkombëtare, 26 lloje janë të përfshira në Listën e Kuqe Evropiane, ndërsa sipas IUCN 32 lloje janë bimë në Listën e Kuqe të bimëve të kërcënuara për zhdukje.

Kosova i përket rajonit Hollarktik përkatësisht nën-rajonit Euro-siberian. Karakterizohet me një faunë mjaft të pasur heterogjene interesante dhe endemike.

Fauna e përbëhet prej 7 lloje peshqish, 9 lloje të ujë-tokësorëve, 8 lloje rrëshqitës, 115 lloje shpendësh dhe 26 lloje gjitarësh, shumë lloje të insekteve etj.

Komuna e Fushë-Kosovës karakterizohet me prezencën e shpendëve shtegtar, si lejleku që ndërton shtrofullat interesante dhe atraktive (fshatrat Henc, Miradi e Poshtme, Miradi e Epërme, Harilaç dhe rreth liqenit të “Hencit”).

Pyjet e larta dhe ekosistemet e Kosovës, në veçanti malet e Sharrit, ofrojnë kushte për jetesën e gjitarëve të mëdhenj, si: Ariu i Murrmë (Ursus-Arktus), Rrëqebulli (lynx - lynx), Kaprolli (kapreolus-kapreolus), dhia e egër (Rupicapra-Rupicapra), pastaj të shumë llojeve të shpendëve grabitqarë dhe këngëtarë, mjaft të rëndësishëm për Ornitofaunën e Kosovës dhe më gjerë, siç janë: Shqiponja e maleve (Aquila chrysaetos), Faikoi thonj-bardhë (Falco Naummani), pula e egër (Tetrao urogallus), janë disa nga llojet më reprezentive të vendit, të cilat kanë status të mbrojtur kombëtar.

Zonat e mbrojtura në Fushë-Kosovë

Emri i objektit: Bima endemike Forsythia Europea-Boshtra;

Viti i shpalljes: 2005;

Kategoria mbrojtëse: Zonë me vlera të veçanta natyrore;

Emri i objektit: Kalaja e Harilaçit dhe Bardhit të Madh;

Viti i shpalljes: 2007;

Kategoria mbrojtëse: Zona turistike-natyrore.

REKOMANDIMET:

- Zgjerimi i sipërfaqeve dhe objekteve të mbrojtura natyrore dhe kulturore;
- Caktimi i kufijve të zonave mbrojtëse;
- Hartografimi i objekteve dhe zonave natyrore, dhe;
- Marrja e vendimit komunal për shpallje si zonë e mbrojtur me vlerë të veçantë natyrore të Gospojes.

3.8. Pylltaria

Një pjesë e territorit të Komunës së Fushë-Kosovës është e mbuluar nga malet. Malet luajnë një rol të rëndësishëm për florën dhe faunën në Komunë, si dhe për klimën globale edhe lokale, por gjithashtu edhe për ekonominë lokale. Për ta siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të pyjeve, prerjet që janë bërë në të kaluarën, duhet të ripyllëzohen me fidanë që rriten në këto anë. Kështu, sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm i maleve. Një pjesë e madhe e zonës kodrinore dhe të zbuluar, duhet të mbulohet, të pyllëzohet. Malet luajnë një rol të rëndësishëm për ekonominë vendore. Druri i siguruar nga këto male përdoret për ndërtim, zanate tradicionale, për përpunim industrial, ngrohje etj.

3.8.1. Sipërfaqja e tokave pyjore

Sipërfaqja e gjithmbarshme e tokave pyjore të Komunës së Fushë-Kosovës është 1619 ha.

Nga këto:

- Pyje - 1619 ha.
- Sipërfaqe të zhveshura - 1100 ha.

Nga kjo sipërfaqe e mbuluar me pyje të ngritura artificialisht (kultura) janë mbi 900 ha të llojeve: pishë e bardhë, pishë e zezë, hormoq, bredh, larq, dugllazion etj.

3.8.2. Gjendja e pyjeve

Gjendja e pyjeve të Komunës së Fushë-Kosovës është e mirë dhe nuk janë sulmuar nga ndonjë agjent patogjen, apo dëmtues tjetër. Vlen të përmendet fakti se gjatë periudhave të nxehta verore kemi paraqitjen e djegieve të pyjeve, të cilat shkaktojnë dëmtime të konsiderueshme të tyre.

Nga regjistrimet e rregullta të terreneve pothuaj se për çdo vit në mënyrë ilegale priten 1.000m³ dhe afro 2.000m³ në mënyrë legale nga prerjet e rregullta, si dhe nga pastrimet sanitare të pyjeve.

3.8.3. Degradimi i pyjeve

Nga shënimet që posedojmë dhe nga puna e deritashme nga drejtorja përkatëse e Fushë-Kosovës, thuhet që pyje të devastuara ose të degraduara kanë një sipërfaqe prej 1100 ha dhe se drejtorja është duke bërë përpjekje që këto sipërfaqe të kthehen në pyje, në sipërfaqe sa më të mëdha. Prej vitit 2008-2011 janë pyllëzuar rreth 100 ha me pisha.

3.8.4. Pyllëzimi i pyjeve

Në vartësi të prodhimitarisë së fidanëve të siguruara nga fidanishtja e Pejës, apo sigurimi i fidanëve nga ndonjë vend tjetër dhe në bazë të projekteve të implementuara nga ana e Komunës së Fushë-Kosovës nga Zyrat e Agjencionit të Pyjeve nëpër komuna, Komuna e Fushë-Kosovës gjithnjë ka qenë njëra ndër Komunat që ka përfutur për çdo vit projekte për pyllëzim në sipërfaqe prej 10 ha, që do të thotë se janë pyllëzuar 100 ha të tokave të pambuluara me pyje dhe se ky aktivitet nuk do të ndërpritet edhe në të ardhmen.

REKOMANDIMET:

- Ndalimi i prerjeve ilegale të pyjeve;
- Marrja e masave për mbrojtje nga zjarret;
- Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura dhe të dëmtuara me fidane të reja;
- Pastrim sanitar i pyjeve;
- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pyjeve;
- Mbrojtja nga dëmtuesit patogjen: mikroorganizmat, krimbat, insektet, brejtësit dhe shpendët dëmtues;
- Ndërtimi i stazave rekreative në pjesët piktoreske të pyjeve dhe;
- Rivitalizim i djerrinave të KEK-ut.

3.9. Dukuritë natyrore dhe të shkaktuara

Territori i Komunës së Fushë-Kosovës është ballafaquar me fatkeqësi natyrore dhe aksidente të ndryshme, ku në masë të madhe shkaktohen dëme materiale, si në pjesën urbane, ashtu edhe në atë rurale. Shpeshherë nga fatkeqësitë aksidentale dhe emergjencave, siç janë:

- Zjarret, Eksplozimet;
- Vërshimet;
- Përmbytjet;
- Aksidentet në komunikacion;
- Aksidentet nga mbeturinat e luftës dhe;
- Tërmetet, si dhe fatkeqësitë të tjera.

3.9.1. Zjarret

Zjarret në territorin e Komunës kanë qenë dhe janë gjithnjë prezentë. Sipas vlerësimeve të bëra, shkaktarët kryesorë të zjarreve janë energjia elektrike dhe pakujdesia e faktorit njeri. Gjatë vitit 2011 ka pasur gjithsej 164 intervenime në shuarjen e zjarreve dhe të aksidenteve të ndryshme.

Komuna e Fushë-Kosovës, në të kaluarën, është ballafaquar me vërshime pas të reshurave të mëdha atmosferike, e sidomos gjatë stinës së vjeshtës dhe të dimrit, mirëpo sot, duke iu falënderuar përfundimit të Projektit të shtratit të lumit “Sitnicë”, gjendja ka ndryshuar për të mirë. Mirëpo, ende vërshimet shkaktohen nga mos përfundimi i shtratit të lumit “Drenicë”.

Shkaktarët kryesorë të vërshimeve, sipas vlerësimit të bërë në terren, janë:

- Shtretërit e parregulluar të lumenjve dhe përroskave;
- Mbyllja e kanaleve të mëparshme dhe;
- Hedhja e mbeturinave në vende joadekuate, si dhe faktorët e tjerë.

3.9.2. Eksplozimet

Në Komunën e Fushë-Kosovës (Zona në mes të Miradisë së Epërme dhe Miradisë së Poshtme) ekziston një numër i madh i objekteve industriale, shpërndarës të karburanteve dhe vajrave (pom-pave të benzinës), si dhe shpërndarës të gazrave të butanit. Ekziston rreziku i shpërthimit të tyre, si pasojë e menaxhimit jo të drejtë të tyre.

3.9.3. Aksidentet në komunikacion

Aksidentet në komunikacion, në territorin e Komunës, janë prezentë për shkak të komunikacionit të dendur dhe gjendjes jo të mirë të rrugëve. Vlen të ceket se në territorin e Komunës kalon hekurudha, pa mbrojtje adekuate në pika të caktuara, që ka si pasojë rritjen e numrit të aksidenteve me pasojë në njerëz dhe dëme materiale.

3.9.4. Aksidentet nga mbeturinat e luftës

Si çdo kund në Kosovë, edhe në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës (në theks të veçantë në Harilaç), janë vendosur mjete eksplozive në mënyrë të fshehtë, të cilat edhe sot po shkaktojnë viktima në njerëz dhe kafshë. Një numër i këtyre mjeteve është zbuluar dhe shkatërruar nga orga-

nizatat e ndryshme profesionale si (ish-TMK), por ende ka terrene të pa pastruara nga mjetet shpërthyes.

3.9.5. Tërmetet

Dridhjet të tokës - tërmete me intensitet të lartë nuk ka pasur, ka pasur lëkundje nga dridhjet e tokës, por pa pasoja në njerëz dhe dëme materiale. Këto dridhje kanë shkaktuar vetëm shqetësim. Dukuritë tjera, që shpesh ndodhin në territorin e Fushë-Kosovës, janë: rrëshqitja e dheut, akullnajat, ortekët e borës, breshëri, si dhe dukuri tjera që shkaktojnë dëme në pasuri bujqësore dhe në infrastrukturë.

REKOMANDIMET:

- Hartimi i planit emergjent për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore;
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve, përroskave që vërshojnë;
- Marrja e vendimit komunal për ndalim të djegies së hamullorëve dhe;
- Aplikimi rigoroz i masave për mbrojtje nga zjarri në të gjitha objektet industriale e veçanërisht nëpër Depot e Karburanteve dhe Pompat e Benzinës.

Pjesa 4

IV. REZULTATET E ANKETËS DHE PRIORITETET

4.1. Hulumtimi i opinionit publik në Komunën e Fushë-Kosovës për gjendjen mjedisore dhe problemet mjedisore me prioritet

Me qëllim të një pasqyrimi të plotë të gjendjes mjedisore, problemeve me prioritet dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik në hapësirat e territorit të Komunës, Qendra Rajonale për Mjedis (REC) dhe Komuna, në kuadër të hartimit të PLVM-së, kanë realizuar një anketë për të hulumtuar opinionin e qytetarëve në tërë territorin e Komunës. Për realizimin e anketës REC-u, në mbështetje të Agjencionit Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar - Sida, ka angazhuar OJQ - Perspektiva Energjetike.

4.2 . Metodologjia

Anketa gjithëpërfshirëse është zhvilluar përmes një Pyetësoari, i cili ka qenë i përpiluar në katër tërësi themelore të pyetjeve:

- Të dhëna bazike për qytetarin e intervistuar;
- Gjendja e tanishme në mjedis;
- Zhvillimi ekonomik në të ardhmen dhe;
- Vizioni zhvillimor.


Pyetësorin e kanë plotësuar personat e trajnuar të OJQ-së, kurse përpunimin e rezultateve të opinionit publik i ka bërë eksperti profesional i angazhuar në kuadër të REC-ut, Zyra në Prishtinë.

4.3. Rezultatet e anketës


Tabela 11. Të dhënat bazë për Komunën e Fushë-Kosovës (Shpërndarja e Mostrës)

| Komuna | Gjinia Moshë # i resp. | Meshkuj (51 %) | | | | | Femra (49 %) | | | | |
|---------------------------------|------------------------------|----------------|-------|-------|-------|-----|--------------|-------|-------|-------|-----|
| | | >18 | 18-25 | 25-50 | 50-65 | 65+ | >18 | 18-25 | 25-50 | 50-65 | 65+ |
| Fushë-Kosovë | 2000 | 10% | 20% | 43% | 20% | 7% | 10% | 20% | 43% | 20% | 7% |
| Fushë-Kosovë (Shqip. – 85 %) | 1700 | 102 | 204 | 442 | 204 | 68 | 98 | 196 | 425 | 196 | 65 |
| Fushë-Kosovë (Min. – 15 %) | 300 | 87 | 173 | 376 | 173 | 58 | 83 | 167 | 361 | 167 | 55 |
| | | 15 | 31 | 66 | 31 | 10 | 15 | 29 | 64 | 29 | 10 |


Gjendja e tanishme mjedisore




Ndotësit kryesor të mjedisit në territorin e Komunës




Pesë (5) problemet kryesore në mjedis



Zhvillimi ekonomik në të ardhmen



Vizioni për të ardhmen



4.9 Çështjet mjedisore, sipas mendimit të Grupit Punues të PLVM-së, të harmonizuara me rezultatet e hulumtimit të opinionit publik për gjendjen mjedisore të Komunës së Fushë-Kosovës dhe zhvillimet me prioritet janë:

1. Mbeturinat;
2. Ujërat e zeza;
3. Uji për pije;
4. Ndotja e ajrit dhe zhurma, dhe;
5. Degradimi i tokës bujqësore dhe i pyjeve.

Pjesa 5

V. ANALIZA E PROBLEMIT MJEDISOR

Analiza e problemit mjedisor është bërë në bazë të këtyre elementeve:

Vlerësimi i problemeve mjedisore bëhet duke definuar problemet e identifikuara, burimin, shkallën e ndikimit, zgjidhja e mundshme dhe autoritete kompetente për zgjidhje.

Kjo qasje bazohet në parimin e përdorur nga Bashkimi Evropian për përcaktimin e indikatorëve dhe përbëhet nga përcaktimi i elementeve vijuese: D-P-S-I-R, forca shtytëse, presioni, gjendja, ndikimet dhe reagimet.



Tabela 12. Analiza e problemeve

| Problemet e identifikuara të komunitetit lokal | Burimi i problemit | Ndikimi në mjedis | Zgjidhjet e mundshme | Autoriteti |
|--|--|--|--|--|
| Ujërat e zeza. | Mungesa e sistemit të kanalizimit në disa vendbanime. | Kontaminimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. | Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në këto vendbanime. | Qeveria, Komuna, donatorët dhe komuniteti. |
| | Mungesa e infrastrukturës për pastrim të ujërave të ndotura. | E lartë | Ndërtimi i kolektorëve. | Qeveria, Komuna dhe donatorët. |
| | Mungesa e infrastrukturës për pastrim të ujërave të ndotura. | E lartë | Ndërtimi i impiantit. | Qeveria dhe Komuna. |

Tabela 13. Analiza e problemeve

| Problemet e identifikuara të komunitetit lokal | Burimi i problemit | Ndikimi në mjedis | Zgjidhjet e mundshme | Autoriteti |
|--|--|---|---------------------------------------|---|
| Mbeturinat | Depot e egra. | Ndotja e tokës, ujit, paraqitja e një mjedisi jo të mirë për komunitetet, rritja e epidemive etj. | Eliminimi i depove. | Komuna dhe donatorët. |
| | Mungesa e një sistemi komunal për grumbullim të mbeturinave. | Formimi i depove të egra, një edukatë e ulët dhe probleme shëndetësore. | Krijimi i kompanisë publike-lokale. | Komuna dhe donatorët. |
| | Mungesa e riciklimit dhe kompostimit. | Ndotje, depojim të mbeturinave vend e pa vend, qentë endacak, infeksione etj. | Projekte për riciklim të mbeturinave. | Qeveria, Komuna, donatorët dhe komunitetet. |
| | Mungesa e një EKO-Depoje. | Ndotje, depojim të mbeturinave vend e pa vend, qentë endacak, infeksione etj. | Ndërtimi i një EKO-Depoje. | Qeveria, Komuna dhe donatorët. |

Tabela 14. Analiza e problemeve

| Problemet e identifikuar të komunitetit lokal | Burimi i problemit | Ndikimi në mjedis | Zgjidhjet e mundshme | Autoriteti |
|---|---|--|---|--|
| Uji për pije dhe vërshimet. | Mungesa e bankinave dhe ngushtimi i shtretërve të lumenjve. | Dëme të mëdha, qofshin ato bujqësore apo të mira materiale. | Ndërtimi i bankinave mbrojtëse. | Qeveria, Komuna dhe donatorët |
| | Mungesë e sistemit të ujit në disa vendbanime dhe kapacitete të ulëta të ujit për pije. | Shfrytëzimi i ujit jo të kontrolluar nga qytetarët, infeksionet jo pastërti etj. | Ndërtimi i puseve në disa lokalitet dhe përmirësimet e rrjeteve ekzistuese, eliminimi i gypave të azbestit. | Ujësjellësi rajonal, Komuna dhe donatorët. |
| | Mungesa e monitorimit të mirëfilltë të cilësisë së ujërave. | Probleme shëndetësore në popullatë. | Monitorim më efikas i cilësisë së ujit. | Ujësjellësi dhe Komuna. |

Tabela 15. Analiza e problemeve

| Problemet e identifikuar të komunitetit lokal | Burimi i problemit | Ndikimi në mjedis | Zgjidhjet e mundshme | Autoriteti |
|---|---|--|---|--|
| Ndotja e ajrit dhe zhurma. | Ndotja e mjedisit, tokës dhe ajrit nga KEK-u. | Rrezikimi i shëndetit të popullatës, sëmundje respiratorë, ndotje e tokës, ndotje e produkteve bujqësore, mjegull etj. | Pyllëzimi i sipërfaqeve mbrojtëse afër depos së hirit, rivitalizimi i lokaliteteve të zhveshura me pisha etj. | KEK, Qeveria dhe Komuna. |
| | Zhurma dhe vibrimet. | I lartë | Plani lokal për zhurmë dhe vibrime. | MMPH, Komuna, Hekurudhat e Kosovës dhe Aeroporti. |
| | Evidentimi i zonave të prekura nga zhurma. | I mesëm | Marrja e masave për punim të projekteve për parandalim të zhurmës në nivele të lejuara. | MMPH, MIK, Komuna, Hekurudhat e Kosovës dhe Aeroporti. |
| | Ndotja e ajrit nga mjetet transportuese. | I lartë Preket e tërë popullata. | Zvogëlimi i mjeteve të vjetra transportuese dhe shfrytëzimi i mjeteve më alternative. | Komuna dhe Qeveria. |
| | Mungesë e parqeve në qytet dhe lokalitetet të tjera. | E mesme | Ndërtim i hapësirave të gjelbëruara rekreative dhe pushuese. | Komuna. |
| | Dëmtimi dhe shkatërrimi i bimësisë dekorative në parqet ekzistuese. | E mesme | Marrja e masave ligjore për dëmtuesit. | Komuna. |

Tabela 16. Analiza e problemeve

| | Burimi i problemit | Ndikimi në mjedis | Zgjidhjet e mundshme | Autoriteti |
|--|--|---|---|---------------------------|
| Degradimi i tokës bujqësore dhe pyjet. | Industria, mihjet e hapura depot e hirit. | Ndotja e tokës, e ujit e ajrit, shëndeti i popullatës. | Zbatimi dhe vendosja e pajisjeve për mbrojtje të mjedisit në industri, si dhe rivitalizimi dhe gjelbërimi i depove. | Qeveria dhe Komuna. |
| | Ndërtim i paplanifikuar në tokën bujqësore. | Zvogëlimi i tokës bujqësore. | Shfrytëzimi më racional i tokës bujqësore. | Qeveria dhe Komuna. |
| | Përdorimi i tepërt i plehrave artificiale dhe pesticideve. | Ndotja e mjedisit, probleme shëndetësore, rrezikim i florës dhe faunës. | Përdorimi profesional i plehrave dhe pesticideve. | Qeveria dhe Komuna. |
| | Zonat e zhveshura. | Erozioni, pluhur, djegiet e këtyre zonave. | Pyllëzimi i këtyre zonave. | Qeveria KEK-u dhe Komuna. |
| | Mungesë e kulturës mjedisore. | Papastërti, hedhje e mbeturinave vend e pavend. | Projekte vetëdijësuese për nxënës. | Qeveria dhe Komuna. |
| | Mungesë e OJQ – mjedisore. | | Stimulim financiar për OJQ-të. | Qeveria dhe Komuna. |

Pjesa 6

VI. PLANI I VEPRIMIT



| Problemi | Veprimi | Prioriteti | Organet përgjegjëse | Gjithsejtë-totali | Efekti në mjedis |
|----------------|--|--------------------|---|------------------------|--|
| Mbeturinat | Menaxhimi i mbeturinave nga strukturat komunale. | I mesëm | Komuna, MMPH, donatorët dhe komuniteti. | 500.000 € | Krijimi i kushteve moderne të menaxhimit të mbeturinave, krijimi i kulturës mjedisore për mbajtje pastër të qytetit dhe fshatrave. |
| | Eliminimi i depove të egra. | I lartë | Komuna, donatorët dhe komuniteti. | 150.000 € | Krijimi i alternativës mjedisore, krijimi i kushteve moderne të menaxhimit të mbeturinave, krijimi i kulturës mjedisore për mbajtje pastër të qytetit dhe fshatrave. |
| | Blerja e kontejnerëve. | I lartë | Komuna, donatorët dhe komuniteti. | 50.000 € | Ambient i pastër, eliminimi i infeksioneve dhe erërave të këqija. |
| | Ndërtimi i EKO-Depos lokale. | I mesëm | MMPH, Komuna, donatorët dhe komuniteti. | 1.000.000 € | Ambient i pastër, riciklim, punësim, zhvillim ekonomik. |
| | Projekte të riciklimit. | I mesëm | MMPH, Komuna, donatorët dhe komuniteti. | 70.000 € | Ambient i pastër, zhvillim ekonomik, punësim. |
| Ujërat e zeza. | Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit. | I lartë | Komuna, donatorët dhe komuniteti. | 100.000 € | Ambient i pastër, zvogëlim të infeksioneve, përmirësimi i kushteve të qytetarëve. |
| | Rregullimi i shtratit të lumit "Drenicë" (Pjesa e I-rë). | I lartë | Komuna, donatorët dhe komuniteti. | 60.000 € | Lumenj të pastër, pastrim nga mbeturinat pamje e bukur, pengim i vërshimeve. |
| | Pastrimi dhe rregullimi i shtratit të përroskës 'Zanoga' nga Aeroporti deri në Henc Pastrimi dhe rregullimi i kanalit në Sllatinë të Madhe | I mesëm I mesëm | Aeroporti, Qeveria, Komuna dhe donatorët. Qeveria, Komuna dhe donatorët. | 200.000 € 150.000 € | Përroska të pastra, pastrim nga mbeturinat, pamje e bukur, pengim i vërshimeve. Kanal të pastër, pastrim nga mbeturinat, pamje e bukur, pengim i vërshimeve. |

| | | | | | |
|----------------------------|---|---------|---|-----------------|---|
| | Pastrimi dhe rregullimi i kanalit në Bardh të Vogël-Kuzmin-Lismir. | I mesëm | Qeveria, Komuna, donatorët dhe komuniteti. | 100.000 € | Kanal të pastër, pastrim nga mbeturinat, pamje e bukur, pengim i vërshimeve. |
| | Ndërtimi i kolektorëve, sipas PZHK-së. | I mesëm | Qeveria, Komuna dhe donatorët. | 150.000 € | Krijimi i kushteve të përshtatshme higjieniko-sanitare të qytetarëve, mbrojtja e lumenjve dhe përroskave nga netoja me ujëra të zeza, mbrojtja e florës dhe faunës. |
| | Impiant për pastrim të ujërave të zeza. | I ulët | Qeveria, Komuna, donatorët dhe komuniteti. | 7.200.000 € | Zgjidhja e problemit të ujërave të zeza, kthimi i ujërave sipërfaqësore në gjendje të kënaqshme natyrore, ringjallja e florës dhe faunës, evitimi i sëmundjeve infektive etj. |
| Uji i pijes. | Menaxhimi i ujit nga strukturat lokale. | I lartë | Komuna, KUR, donatorët dhe komuniteti. | 350.000 € | Rritja e kapaciteteve të furnizimit me ujë të pijes, përfitojnë 40.000 banorë. |
| | Përmirësimi i sistemit ekzistues të ujësjellësit. | I lartë | Komuna, KUR, donatorët dhe komuniteti. | 160.000 € | Zgjidhja e problemit të ujësjellësit, ngritja e cilësisë dhe sasisë së ujit, ngritja e kushteve të jetesës, zvogëlimi i infeksioneve etj. |
| | Hapja e puseve të ujit nëpër fshatra. | I lartë | Komuna, KUR, donatorët dhe komuniteti. | 200.000 € | Rritja e kapaciteteve të furnizimit me ujë të pijes, ngritja e standardit jetësor etj. |
| | Vendosja e miniimpianitit për trajtim të ujërave të zeza nëpër fabrika. | I mesëm | Fabrika, qumështoret, donatorët dhe komuniteti. | I pa llogaritur | Mbrohen lumenjtë nga ndotja me materie kimike, mbrohet popullata, largohen erërat e këqija, mbrohet flora dhe fauna. |
| Ndotja e ajrit dhe zhurma. | Hartimi i Planit Lokal për Mbrojtje të ajrit nga ndotja. | I lartë | Komuna, donatorët dhe komuniteti. | 10.000 € | Merren masa dhe projekte për mbrojtje të ajrit nga ndotësit, përfitojnë 40.000 banorët e Komunës së Fushë-Kosovës. |

| | | | | | |
|--|--|---------|---|-----------------|---|
| | Revitalizimi i zonave të zhveshura. | I lartë | Qeveria, Komuna, donatorët dhe komuniteti. | 70.000 € | Pastrim i ajrit, ulje e efektit të ndotjes së ajrit, imazh mjedisor më i mirë. |
| | Ndërtimi i parqeve dhe parkingjeve. | I lartë | Qeveria, Komuna, donatorët dhe komuniteti. | 200.000 € | Përmirësim të peizazhit, rritja e mjediseve çlodhëse për komunitete. |
| | Asfaltimi i rrugëve në Fushë-Kosovë dhe fshatra. | I lartë | Qeveria, Komuna, donatorët dhe komuniteti. | 1.000.000 € | Ulja e ndotjes së ajrit, ulja e sëmundjeve respiratorë dhe të syve. |
| | Ndërtimi i sistemit monitorues të ajrit. | I mesëm | Qeveria, Komuna, donatorët dhe komuniteti. | Pa llogaritur | Njohja e saktë e situatës ndotëse, mundësitë për ndërhyrje. Evitohet ndotja e mëtutjeshme e tokës, ajrit, ujit. |
| | Evidentimi i zonave të atakuara nga zhurma. | I ulët | Qeveria, Komuna, donatorët dhe komuniteti. | Pa llogaritur | Përmirësim i situatës mjedisore, ulje të çrregullimeve neurotike të shkaktuara nga zhurma dhe vibrimet, ulje të stresit mjedisor. |
| | Ndërtimi i mureve mbrojtëse kundër zhurmës dhe pluhurit në Graboc dhe Bardh. | I lartë | Qeveria, KEK-u, Komuna, donatorët dhe komuniteti. | Pa llogaritur | Përmirësim i situatës mjedisore, ulje të çrregullimeve neurotike të shkaktuara nga zhurma dhe vibrimet, ulje të stresit mjedisor. |
| | Ndërtimi i parrakëve mbrojtës në rrugën M-9 dhe autostradë. | I Mesëm | Qeveria, Komuna dhe donatorët. | I pa llogaritur | Përmirësim i situatës mjedisore, ulje të çrregullimeve neurotike të shkaktuara nga zhurma dhe vibrimet, ulje të stresit mjedisor. |
| | Ndërtimi i zonave mbrojtëse gjelbëruese përreth depove të karburanteve. | I lartë | Kompanitë e karburanteve, Komuna dhe donatorët. | 100.000€ | Përmirësim i situatës mjedisore, ulje të erërave të këqija të shkaktuara nga karburantet, ulje të stresit mjedisor. |
| Degradimi i tokës bujqësore dhe pyjet. | Hartimi i rregulloreve lokale për mbrojtjen e tokës dhe pyjeve, në | I lartë | Komuna dhe donatorët. | | Implementimi i ligjeve, mbrojtja e tokës, e ujit dhe pyjeve, mbrojtja e florës dhe faunës. Përfitojnë të gjithë qytetarët. |

| | | | | | |
|--|--------------------------------------|---------|--------------------------------|-----------|---|
| | përputhje me ligjet. | | | | |
| | Subvencionim i fermerëve | I lartë | Qeveria, Komuna dhe donatorët. | 300.000 € | Zhvillim ekonomik, ngritja e agrobizneseve dhe impianteve për përpunim të prodhimeve bujqësore. |
| | Ndërtimi i sistemit të ujitjes. | I lartë | Qeveria, Komuna dhe donatorët. | 500.000 € | Shtimi i prodhimeve bujqësore, zhvillim ekonomik etj. |
| | Pastrimi sanitar i pyjeve. | I lartë | Komuna. | 40.500 € | Pastrimi i pyjeve nga barojat e këqija mbrojtje e florës dhe faunës, peizazhe më të mira. |
| | Pyllëzim i sipërfaqeve të zhveshura. | I lartë | Qeveria, Komuna dhe donatorët. | 40.000 € | Pastrim i ajrit, ulje e efektit të ndotjes së ajrit, imazh mjedisor më i mirë, zvogëlimi i rrëshqitjes së dheut, zvogëlim i dëmeve mjedisore nga zjarret etj. |
| | Zhdukja e qenve endacakë. | I lartë | Komuna. | 30.000 € | Siguria e qytetarëve. |

PROJEKTET SHITESË NGA EKSPERTËT - PLANI I VEPRIMIT

Menaxhimi i mbeturinave

Aktivite legjislative dhe politike (L)

| Nr. i aktiviteve | Lokacioni | Përshkrimi | Kriteret/treguesit e suksesit (*) |
|------------------|------------|--|---|
| L1 | F. Kosovë. | Zhvillimi i rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave ngurta. | Janë të qarta përgjegjësitë e grupit kryesore të interesit. |
| L2 | F. Kosovë. | Zhvillimin e planit komunal për mbeturinat. | Përgjegjësitë e të gjitha grupeve të interesit janë të qarta dhe janë identifikuar burimet buxhetore. |
| L3 | F. Kosovë. | Rishikimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave. | Përgjegjësitë e të gjitha grupeve të interesit janë të qarta dhe janë identifikuar burimet buxhetore. |
| L4 | F. Kosovë. | Zhvillimi i gjashtë (6) raporteve mujore mbi gjendjen e mbeturinave në Komunë. | MMPH dhe popullata nëpër komuna janë të informuar. |
| L5 | F. Kosovë. | Zhvillimi i broshurave apo udhërrëfyesve për reduktimin, ripërdorimin, riciklimin, djegien dhe deponimin e mbeturinave. | Popullata është më e informuar për ciklin e mbeturinave. |
| L6 | F. Kosovë. | Zhvillimi i rregullores komunale për Eko-taksa, taksa për qeset e najlonit dhe nxitjet e tjera për produkte miqësore për mjedisin. | Parimi, ndotësi paguan është i pranuar nga shumica e qytetarëve. |

Aktivitetet administrative dhe të inspektoratit (A)

| Nr. i aktiviteve | Lokacioni | Përshkrimi | Kriteret/treguesit e suksesit (*) |
|------------------|------------|--|---|
| A1 | F. Kosovë. | Ngritja e kapaciteteve për stafin për menaxhim të mbeturinave dhe leje. | Numri i stafit të trajnuar. |
| A2 | F. Kosovë | Ngritja e kapaciteteve për ekspertët e mjedisit nga kompanitë regjionale për menaxhimin e mbeturinave dhe hedhjen e mbeturinave. | Numri i stafit të trajnuar. |
| A3 | F. Kosovë. | Programe për ndërgjegjësim publik për menaxhimin e ciklit të mbeturinave. | Numri i njerëzve dhe OJQ-ve që kanë marr pjesë. |
| A4 | F. Kosovë. | Ngritja e kapaciteteve për inspektorë. | Numri i stafit të trajnuar. |

Aktivitetet teknike dhe teknologjike (T)

| Nr. i aktiviteteve | Lokacioni | Përshkrimi | Kriteret/treguesit e suksesit (*) |
|--------------------|------------|---|--|
| T1 | F. Kosovë. | Auditimi Mjedisor (AM) i situatës për MMN në komuna. | Raporti AM i miratuar me pjesëmarrjen e komunitetit. |
| T2 | F. Kosovë. | Zhvillimi i stacioneve të vogla të transferimit për grumbullimin e mbeturinave regjionale. | Zgjidhje e qëndrueshme për gjithë komunitetin dhe për kohë të gjatë. |
| T3 | F. Kosovë. | Futja e qendrave pranë supermarketeve për mbledhjen e materialeve për riciklim (plastikë, letër, kanoçe etj). | Zgjidhje e qëndrueshme për gjithë komunitetin dhe për kohë të gjatë. |
| T4 | F. Kosovë. | Zgjerimi i sistemit të mbledhjes në zonat rurale. | Zgjidhje e qëndrueshme për gjithë komunitetin dhe për kohë të gjatë. |
| T5 | F. Kosovë. | Blerja e pajisjeve të reja për mbledhjen dhe asgjësimin e mbeturinave. | |

PLANI I DETAJUAR I ZBATIMIT TË AKTIVITETEVE

| | |
|--------------------------|---|
| Regjioni | Prishtina |
| Aktiviteti (L, A, T) Nr. | L1 |
| Emri i Aktivitetit | Zhvillimi i një rregullore komunale për menaxhimin e mbeturinave të ngurta. |
| Lokacioni | F. Kosova. |
| Objektivat | Objektiva kryesore është që të zhvillohet një rregullore mjedisore e cila është në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe të identifikoj qartë përgjegjësitë e Komunës dhe kompanive për menaxhimin e mbeturinave, dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel lokal. |
| Komenti | Rregullorja e mjedisit duhet të jetë shumë e thjeshtë dhe në harmoni me rregulloret e mjedisit nëpër komunat tjera dhe në linjë me rregulloren qendrore. |

| Faza e punës: | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt (euro) |
|--|---------------------------------|-------------------------|
| 1 Krijimi i grupit punues. | Komuna, MMPH-ja, dhe kompanitë. | 2000 |
| 2 Angazhimi i ekspertëve. | Komuna dhe donatorët. | 15 000 |
| 3 Publikimi i parë i draftit dhe debatet publike. | Komuna, MMPH-ja dhe donatorët. | 2000 |
| 4 Hartimi i draftit final, aprovimi dhe publikimi. | Komuna. | 3000 |
| 5 | Totali | 22 000 |

Afati i zbatimit të planit

| Faza e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|--------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | | | | | x | | | | | | | | |
| 2 | | | | | | X | X | X | | | | | |
| 3 | | | | | | X | X | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | X | | | | | |

| | | | |
|--------------------------|--|--------------------------------|--------|
| Regjioni | Prishtina | | |
| Aktiviteti (L, A, T) Nr. | L4 | | |
| Emri i aktivitetit | Zhvillimi i planit për menaxhimin e mbeturinave komunale. | | |
| Lokacioni | F. Kosova. | | |
| Objektivat | Objektiva kryesor është që të zhvillohet një plan komunal për menaxhimin e mbeturinave, i cili është në përputhje me strategjinë e menaxhimit të mbeturinave kombëtare dhe identifikon qartë veprimet, dhe përgjegjësit e komunave dhe kompanive për katër (4) vjet. | | |
| Komenti | Ky është një obligim prej ligjit të mbeturinave | | |
| Faza e punës: | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt (euro) | |
| 1 | Krijimi i grupit punues. | Komuna, MMPH-ja dhe kompanitë. | 3000 |
| 2 | Angazhimi i ekspertëve. | Komuna dhe donatorët. | 30 000 |
| 3 | Publikimi i parë i draftit dhe debatet publike. | Komuna, MMPH-ja dhe donatorët. | 2000 |
| 4 | Hartimi i draftit final, aprovimi dhe publikimi. | Komuna. | 3000 |
| 5 | | Totali | 38 000 |

Afati i zbatimit të planit

| Faza e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|--------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | X | | | | x | | | | | | | | |
| 2 | | x | X | | | | | | | | | | |
| 3 | | | X | | | | X | X | | | | | |
| 4 | | | | | | | | X | | | | | |

| | | | |
|--------------------------|--|--|--|
| Regjioni | Prishtina | | |
| Aktiviteti (L, A, T) Nr. | L5 | | |
| Emri i aktivitetit | Zhvillimi i raportit gjashtë (6) mujor për gjendjen e menaxhimit të mbeturinave në Komunë. | | |
| Lokacioni | F. Kosova. | | |
| Objektivat | Objektiva kryesor është të zhvillojë një raport mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturinave në komuna për çdo gjashtë (6) muaj dhe për të informuar popullatën dhe të tjerët në lidhje me gjendjen e mbeturinave në komuna. | | |
| Komenti | Ky është një obligim prej ligjit të mbeturinave. | | |

| | | | |
|---------------|--|--------------------------------|-------|
| Faza e punës: | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt | |
| 1 | Krijimi i grupit punues. | Komuna dhe MMPH-ja. | 1000 |
| 2 | Angazhimi i ekspertëve. | Komuna dhe donatorët. | 5 000 |
| 3 | Publikimi i parë i draftit dhe debatet publike. | Komuna, MMPH-ja dhe donatorët. | 2000 |
| 4 | Hartimi i draftit final, aprovimi dhe publikimi. | Komuna. | 1000 |
| 5 | Raporton tek MMPH-ja. | Komuna. | |
| | | Totali | 9 000 |

Afati i zbatimit të planit

| Faza e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|--------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | X | | | | | | | | | | | | |
| 2 | | X | X | | | | | | | | | | |
| 3 | | X | | | | | | | | | | | |
| 4 | | x | | | | | | | | | | | |
| 5 | | | X | | x | | X | | x | | X | | x |

| | |
|--------------------------|--|
| Regjioni | Prishtina |
| Aktiviteti (L, A, T) Nr. | L6 |
| Emri i aktivitetit | Krijimi i broshurave dhe udhëzuesve për reduktimin e mbeturinave, ripërdorimin, riciklimin, kompostimin dhe deponimin e mbeturinave. |
| Lokacioni | F. Kosovë. |
| Objektivat | Objektiva kryesor është krijimi i broshurave dhe udhëzuesve për reduktimin e mbeturinave, ripërdorimin, riciklimin, kompostimin dhe deponimin e mbeturinave për të gjithë për të përmirësuar mbrojtjen e mjedisit. |

| Faza e punës: | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt |
|--|--------------------------------|------------------|
| 1 Krijimi i grupit punues. | Komuna dhe MMPH-ja. | 3000 |
| 2 Angazhimi i ekspertëve. | Komuna dhe donatorët. | 25000 |
| 3 Hartimi i parë i publikimit. | Komuna, MMPH-ja dhe donatorët. | 3000 |
| 4 Hartimi i draftit final, aprovimi dhe publikimi. | Komuna, MMPH-ja dhe donatorët. | 10000 |
| | Totali | 41 000 |

Afati i zbatimit të planit

| Faza e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|--------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | X | | | | x | | | | x | | | | |
| 2 | | X | X | X | | X | x | X | | X | X | X | |
| 3 | | | | X | | | | X | | | | X | |
| 4 | | | | x | | | | X | | | | X | |

| | |
|--------------------------|--|
| Regjioni | Prishtina |
| Aktiviteti (L, A, T) Nr. | L7 |
| Emri i aktivitetit | Zhvillimi i rregullores komunale për Eko-taksa, taksa për qeset e najlonit dhe nxitjet e tjera për produktet miqësore për mjedisin. |
| Lokacioni | F. Kosova. |
| Objektivat | Objektiva kryesor është krijimi i një rregulloreje mjedisore komunale për instrumentet ekonomike, bazuar në parimin ndotësi paguan, dhe reduktimi i mbeturinave në nivel lokal |
| Komenti | Parimi - Ndotësi paguan është i pranuar nga shumica e qytetarëve. |

| Faza e punës: | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt |
|--|--------------------------------|------------------|
| 1 Krijimi i grupit punues. | Komuna dhe MMPH-ja. | 2000 |
| 2 Angazhimi i ekspertëve. | Komuna dhe donatorët. | 10000 |
| 3 Drafti i parë dhe debatet publike. | Komuna, MMPH-ja dhe donatorët. | 5000 |
| 4 Hartimi i draftit final, aprovimi dhe publikimi. | Komuna, MMPH-ja dhe donatorët. | 3000 |
| | Totali | 20 000 |

Afati i zbatimit të planit

| Faza e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|--------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | | | x | | | | | | | | | | |
| 2 | | | | X | x | X | | | | | | | |
| 3 | | | | | | X | X | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | X | | | | | |

| | |
|--------------------------|--|
| Regjioni | Prishtina |
| Aktiviteti (L, A, T) Nr. | A1 |
| Emri i aktivitetit | Ngritja e kapaciteteve të stafit për menaxhimin e mbeturinave dhe lejimin. |
| Lokacioni | F. Kosova. |
| Objektivat | Objektiva kryesor është të trajnojnë stafin për të zhvilluar dokumentet e politikave, planeve dhe instrumenteve të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit në nivel lokal. |
| Komenti | Për stafin e trajnuar duhet të zhvillohen disa instrumente stimuluese për të qëndruar në këtë institucion. |

| Faza e punës: | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt |
|---|-----------------------------------|------------------|
| 1 Zhvillimi i nevojave për trajnim. | Komuna dhe MMPH-ja. | 2000 |
| 2 Përgatitja e pikave të referencës dhe përshkrimi i projektit. | Komuna dhe donatorët. | 7000 |
| 3 Përgatitja e procedurave të tenderimit dhe përzgjedhja e kompanisë. | Komuna, MMPH-ja dhe donatorët. | 5000 |
| 4 Implementimi i projektit. | Kompania e zgjedhur dhe donatori. | 50 000 |
| | Totali | 64 000 |

| Faza e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|--------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | | | X | | | | | | | | | | |
| 2 | | | | X | X | X | | | | | | | |
| 3 | | | | | | X | X | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | X | x | X | | | |

| | |
|--------------------------|--|
| Regjioni | Prishtina |
| Aktiviteti (L, A, T) Nr. | A2 |
| Emri i aktivitetit | Ngritja e kapaciteteve të ekspertëve mjedisor të kompanive regjionale në menaxhimin e mbeturinave dhe largimin e mbeturinave. |
| Lokacioni | F. Kosova. |
| Objektivat | Objektiva kryesor është të trajnojë stafin për të zhvilluar një plan pune dhe instrumente të ndryshme për menaxhimin e mbeturinave për kompanitë që gjenden atje dhe gjithashtu të jenë më të familjarizuar me ligjet dhe rregulloret. |

| Faza e punës: | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt |
|---|-----------------------------------|------------------|
| 1 Zhvillimi i nevojave për trajnim. | Komuna dhe kompanitë. | 10 000 |
| 2 Përgatitja e pikave të referencës dhe përshkrimi i projektit. | Komuna dhe donatorët. | 10 000 |
| 3 Përgatitja e procedurave të tenderimit dhe përzgjedhja e kompanisë. | Komuna, MEF, MESP dhe donatorët. | 5000 |
| 4 Implementimi i projektit. | Kompania e zgjedhur dhe donatori. | 150 000 |
| | Totali | 175 000 |

| Faza e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|--------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | | | X | X | | | | | | | | | |
| 2 | | | | X | X | X | | | | | | | |
| 3 | | | | | | X | X | X | | | | | |
| 4 | | | | | | | | X | x | x | X | X | |

| | |
|--------------------------|---|
| Regjioni | Prishtina |
| Aktiviteti (L, A, T) Nr. | A3 |
| Emri i aktivitetit | Programet për vetëdijesimin e popullatës dhe aktivitetet për menaxhimin e ciklit të mbeturinave. |
| Lokacioni | F. Kosova. |
| Objektivat | Objektiva kryesor është të trajnimi i stafit në komuna dhe OJQ-të për të zhvilluar programe të vetëdijesimit dhe aktiviteteteve të ndryshme për menaxhimin e mbeturinave dhe për mbrojtjen e mjedisit në nivel lokal. |

| Faza e punës: | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt |
|---------------|---|------------------|
| 1 | Zhvillimi i nevojave për trajnim. | 2000 |
| 2 | Përgatitja e pikave të referencës dhe përshkrimi i projektit. | 5000 |
| 3 | Përgatitja e procedurave të tenderimit dhe përzgjedhja e kompanisë. | 2000 |
| 4 | Implementimi i projektit. | 70 000 |
| 5 | | |
| | Totali | 79 000 |

| Faza e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|--------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | | | X | | | | | | | | | | |
| 2 | | | | X | X | X | | | | | | | |
| 3 | | | | | | X | X | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | X | x | x | X | X | X |
| 5 | | | | | | | | | | | | | |

| | |
|--------------------------|--|
| Regjioni | Prishtina |
| Aktiviteti (L, A, T) Nr. | T1 |
| Emri i aktivitetit | Raporti i AM-së mbi menaxhimin e mbeturinave. |
| Lokacioni | F. Kosova. |
| Objektivat | Objektiva kryesor është për të bërë një raport të AM-së për administrimin e mbeturinave në atë zonë, për të gjetur problemet dhe për të shmangur ndikimet negative mbi popullsinë dhe zonat e mbrojtura. |
| Komenti | Raporti i AM-së është për vlerësimin e gjendjes së mbeturinave dhe ndikimeve. |

| Faza e punës: | | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt |
|---------------|--|--------------------------------|------------------|
| 1 | Zhvillimi i pikave të referencës për projektin. | Komuna dhe MMPH-ja. | 5000 |
| 2 | Angazhimi i ekspertëve ose i kompanive. | Komuna dhe donatorët. | 50 000 |
| 3 | Publikimi i parë i draftit dhe debatet publike. | Komuna, MMPH-ja dhe donatorët. | 5000 |
| 4 | Hartimi i draftit final, aprovimi dhe publikimi. | MESP dhe Komuna. | 2000 |
| 5 | | Totali | 63 000 |

Afati i zbatimit të planit

| Faza e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|--------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | | | X | | | | | | | | | | |
| 2 | | | | X | X | X | | | | | | | |
| 3 | | | | | | X | X | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | X | | | | | |
| 5 | | | | | | | | | | | | | |

| | |
|--------------------------|--|
| Regjioni | Prishtina |
| Aktiviteti (L, A, T) Nr. | T2 |
| Emri i aktivitetit | Zhvillimi i stacioneve të vogla të transferimit për grumbullimin e mbeturinave. |
| Lokacioni | F. Kosova. |
| Objektivat | Objektiva kryesor është që të krijohet stacione të vogla për transferimin për grumbullimin dhe përzgjedhjen e mbeturinave në zonat rurale ku qytetarët mund të e dërgojnë mbeturinat në mënyrë individuale apo të organizuar nga KRGM-të, si zgjedhje më e drejt për kohë më të gjatë dhe të reduktoj ndotjen. |

| Faza e punës: | | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt (euro) |
|---------------|---|-----------------------------------|-------------------------|
| 1 | Përgatitja e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet komunave, kompanive rajonale dhe qytetarëve. | Komuna dhe MMPH-ja. | 1500 |
| 2 | Përgatitja e pikave të referencës dhe përshkrimi i projektit. | Komuna dhe donatorët. | 10 000 |
| 3 | Përgatitja e procedurave të tenderit dhe përzgjedhja e kompanisë. | Komuna, MMPH-ja dhe donatorët. | 2000 |
| 4 | Implementimi i projektit. | Kompania e zgjedhur dhe donatori. | 130 000 |
| 5 | | Totali | 5 43 500 |

Afati i zbatimit të planit

| Faza e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|--------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | x | X | x | X | | | | | | | | | |
| 2 | | | | | x | X | | | | | | | |
| 3 | | | | | | X | X | X | | | | | |
| 4 | | | | | | | | X | x | x | X | X | X |
| 5 | | | | | | | | | | | | | |

| | |
|--------------------------|--|
| Regjioni | Prishtina |
| Aktiviteti (L, A, T) Nr. | T3 |
| Emri i aktivitetit | Prezantimi i qendrave afër supermarketeve për grumbullimin e materialeve të riciklueshme (plastikës, letrës, kanoçeve etj.). |
| Lokacioni | F. Kosova. |
| Objektivat | Objektiva kryesor është që të krijoj qendra grumbullimi dhe përzgjedhjeje afër supermarketeve dhe krijimin e forcave shtytëse për grumbullimin e materialeve për riciklim e plastikës, letrës, kanoçeve dhe produkteve elektrike elektronike, duke i rikthyer blerësve të produkteve të supermarketit për grumbullimin e këtyre materialeve. |
| Komenti | Ky projekt duhet të jetë prioritet kryesor për qeverinë dhe komunat. |

| Faza e punës: | | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt (euro) |
|---------------|--|---|-------------------------|
| 1 | Përgatitja e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet komunave: Pejë, Klinë, kompanive rajonale, qendrave të riciklimit dhe supermarketeve. | Komuna, MMPH-ja dhe kompanitë rajonale. | 2500 |
| 2 | Përgatitja e pikave të referencës dhe përshkrimi i projektit. | Komuna, donatorët dhe kompanitë rajonale. | 20 000 |
| 3 | Përgatitja e procedurave të tenderit dhe përzgjedhja e kompanisë. | Komuna, MMPH dhe donatorët. | 2000 |
| 4 | Implementimi i projektit. | Kompania e zgjedhur dhe donatori. | 200 000 |
| 5 | | Totali | 224 500 |

Afati i zbatimit të planit

| Faza e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|--------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | x | X | X | X | | | | | | | | | |
| 2 | | | | | x | X | | | | | | | |
| 3 | | | | | | X | X | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | X | x | x | X | X | X |
| 5 | | | | | | | | | | | | | |

| | |
|--------------------------|--|
| Regjioni | Prishtina |
| Aktiviteti (L, A, T) Nr. | T4 |
| Emri i aktivitetit | Zgjerimi i grumbullimit në zonat rurale. |
| Lokacioni | F. Kosova. |
| Objektivat | Objektiva kryesore është zgjerimi i sistemit të mbledhjes në zonat rurale, si zgjidhje e drejtë për kohë të gjatë dhe të reduktojë ndotjen e lumenjve. |
| Komenti | Ky projekt duhet të jetë prioritet kryesor për Qeverinë dhe komunat me përfshirjen e donatorëve kyç. |

| Faza e punës: | | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt (euro) |
|---------------|---|---|-------------------------|
| 1 | Përgatitja e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet komunave dhe kompanive rajonale. | Komuna, MMPH-ja dhe kompanitë rajonale. | 500 |
| 2 | Përgatitja e pikave të referencës dhe përshkrimi i projektit. | Komuna, donatorët dhe kompanitë rajonale. | 20 000 |
| 3 | Përgatitja e procedurave të tenderit dhe përzgjedhja e kompanisë. | Komuna, MMPH dhe donatorët. | 2000 |
| 4 | Implementimi i projektit. | Kompania e zgjedhur dhe donatori. | 7,000 000 |
| 5 | | Totali | 7 022 500 |

Afati i zbatimit të planit

| Faza e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|--------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | | | x | x | | | | | | | | | |
| 2 | | | | | X | X | | | | | | | |
| 3 | | | | | | X | X | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | X | x | x | X | X | X |
| 5 | | | | | | | | | | | | | |

| | |
|--------------------------|--|
| Regjioni | Prishtina |
| Aktiviteti (L, A, T) Nr. | T5 |
| Emri i aktivitetit | Blerja e pajisjeve të reja për mbledhjen dhe asgjësimin e mbeturinave. |
| Lokacioni | F. Kosova. |
| Objektivat | Objektiva kryesor është blerja e pajisjeve për grumbullimin dhe hedhjen e mbeturinave në atë vend për përmirësimin e sistemit të grumbullimit. |
| Komenti | Ky projekt duhet të jetë prioritet kryesor për Qeverinë dhe komunat me përfshirjen e donatorëve kyç. |

| Faza e punës: | | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt (euro) |
|---------------|---|---|-------------------------|
| 1 | Përgatitja e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet komunave dhe kompanive rajonale. | Komuna, MMPH-ja dhe kompanitë rajonale. | 1500 |
| 2 | Përgatitja e pikave të referencës dhe përshkrimi i projektit. | Komuna dhe kompanitë rajonale. | 5000 |
| 3 | Përgatitja e procedurave të tenderit dhe përzgjedhja e kompanisë. | Komuna, MMPH, MEF dhe donatorët. | 2000 |
| 4 | Implementimi i projektit. | Kompania e përzgjedhur, kompanitë rajonale, donorët | 3 000 000 |
| 5 | | Totali | 3 008 500 |

Afati i zbatimit të planit

| Faza e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|--------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | | | X | X | X | | | | | | | | |
| 2 | | | | | | X | X | | | | | | |
| 3 | | | | | | X | X | X | | | | | |
| 4 | | | | | | | | | x | x | x | X | X |

Menaxhimi i ujërave të zeza

PLANI I VEPRIMIT

Aktivite Ligjore dhe Politike (L)

| Aktiviteti | Lokacioni | Përshkrimi | Kriteri/Indikatorët e suksesit |
|------------|---------------|---|---|
| L1 | Fushë-Kosovë. | Hartimi i rregullores komunale për zbatimin e legjislacionit qendror për aktivitetet ndotëse. | Ujja e ndotjes dhe mbrojtja e resurseve ujore. |
| L2 | Fushë-Kosovë. | Hartimi i rregullores komunale për detyrimet e bizneseve lidhur me shkarkimet e ujërave të përdorura. | Identifikimi i nr. të bizneseve, si ndotës potencial. |

Aktivite Administrative dhe Inspektuese (A)

| Aktiviteti | Lokacioni | Përshkrimi | Kriteri/indikatorët e suksesit |
|------------|---------------|---|---|
| A1 | Fushë-Kosovë. | Ngritja e kapaciteteve për inspektorët mjedisor. | Numri i stafit të trajnuar |
| A2 | Fushë-Kosovë. | Kampanjë vetëdijesimi për mbrojtjen e mjedisit, resurseve ujore | Nr. i pronarëve të bizneseve dhe banorëve të trajnuar, broshurat e botuara, mediat dhe OJQ-të lokale. |

Aktivite Teknike dhe Teknologjike (T)

| Aktiviteti | Lokacioni | Përshkrimi | Kriteri/Indikatorët e suksesit |
|------------|---------------|---|--|
| T1 | Fushë-Kosovë. | Ndërtimi i rrjeteve të ndara për Kanalizim dhe ujëra atmosferike. | Gjatësia e rrjetit të ndarë dhe përmirësimi i cilësisë të ujë-rrjedhave. |
| T2 | Fushë-Kosovë. | Rehabilitimi dhe zgjerim i infrastrukturës të kanalizimit të ujërave të zeza. | Mbulueshmëria me rrjeti të kanalizimit në territorin e zonës urbane. |
| T3 | Fushë-Kosovë. | Ndërtimi i kolektorëve dhe përgatitje e infrastrukturës për kyçe në impiantin rajonal. | Rritja e kapacitetit përmbledhës për shkarkim në impiantin rajonal. |
| T4 | Fushë-Kosovë. | Ndërtimi i sistemit të kanalizimit kolektiv në zonat rurale, trajtimi biofushor dhe gropat septike. | Vendbanimet rurale me sistem të kanalizimit. |

L1 Plani i detajuar i implementimit të aktiviteve

| | |
|--------------------|--|
| Lokacioni | Fushë-Kosovë |
| Aktiviteti | L1 |
| Emri i aktivitetit | Hartimi i rregullores komunale për zbatimin e legjislacionit qendror për aktivitetet ndotëse. |
| Objektivi | Zhvillimi i rregullores në përputhje me legjislacionin aktual dhe përforcimi i gjobave në nivel lokal. |
| Komente | Ky projekt duhet të jetë prioritar për Komunën me përfshirjen e donatorëve kyç, pasi është faza e parë për zgjidhjen e problemeve të ndotjes së ujë-rrjedhave. |

| Fazat e punës | Organizata përgjegjëse | Vlera e përafërt (€) |
|--|-------------------------------------|----------------------|
| 1 Formimi i grupit punues. | Komuna dhe MMPH. | 1000 |
| 2 Involvim i ekspertëve për hartimin e rregullores komunale dhe debati publik. | Komuna, MMPH, OJQ-të dhe donatorët. | 10000 |
| 3 Aprovimi dhe publikimi i dokumentit final. | Komuna. | 2000 |
| | Totali | 13000 |

Plani i implementimit

| Fazat e punës | Viti i parë | | | | Viti i dytë | | | | Viti i tretë | | | | Viti i katërt |
|---------------|-------------|---|---|---|-------------|---|---|---|--------------|---|---|---|---------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | |
| 1 | X | | | | | | | | | | | | |
| 2 | | X | | | | | | | | | | | |
| 3 | | | X | | | | | | | | | | |

L2 Plani i detajuar i implementimit të aktiviteve

| | |
|--------------------|--|
| Lokacioni | Fushë-Kosovë |
| Aktiviteti | L2 |
| Emri i aktivitetit | Hartimi i rregullore komunale për detyrimet e bizneseve lidhur me shkarkimet e ujërave të përdorura. |
